

UNIVERSITETI I EJL
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈИЕ
SEE UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
LAW FACULTY

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

DREJTIMI: E DREJTA KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

TEZA:

**KAPACITETET E DECENTRALIZIMIT DHE TË TRANSPARENCËS SË
QEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT-
STUDIM RASTI: KOMUNA E STUDENIÇANIT**

KANDIDATI:

Xhelal ZEQRIRI

MENTORI:

Prof. Dr. sc. Jeton SHASIVARI

Tetovë, Mars, 2021

DEKLARATË

Une Xhelal Zeqiri deklaroj dhe vertetoj se une jam autor origjinal i këtij punimi te magjistratures me titullin: **"Kapacitetet e decentralizimit dhe të transparencës së qeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut-Rast Studimi: Komuna e Studeniçanit"** dhe te gjitha referencat e shenuara ne kete punim si dhe citimet apo sherbimet e ndryshme te marrura nga burimet e ndryshme materiale apo elektronike jane te shenuara me fusnota dhe ne fund te çdo faqeje si dhe ne fund te ketij punimi. Me kete rast, poashtu deklaroj se Universitetit ia barti te gjitha te drejtat autoriale te ketij punimi, per qellime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Mars, 2021, Shkup

Xhelal Zeqiri, ID:102776

PËRMBAJTJA	3
Abstrakt/ Анстракт/Abstract	4
HYRJE	6
KAPITULLI I PARË	12
DECENTRALIZIMI I QEVERISJES LOKALE NË RMV	12
1.1Kuptimi i qeverisjes lokale.....	12
1.2Koncepti kushtetues i qeverisjes lokale në RMV.....	18
1.3Koncepti ligjor i qeverisjes lokale në RMV.....	20
1.4Qeverisja lokale në RMV pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.....	23
1.5Organizimi territorial i qeverisjes lokale në RMV.....	25
1.6Procesi i decentralizimit të kompetencave të qeverisjes lokale në RMV.....	28
KAPITULLI I DYTË	31
KOMPETENCAT KOMUNALE, ORGANET E QEVERISJES LOKALE DHE DEMOKRACIA LOKALE NË RMV	31
2.1Kompetencat komunale të qeverisjes lokale në RMV.....	31
2.2Organet e qeverisjes lokale në RMV.....	34
2.2.1Keshilli i Komunës.....	34
2.2.2Kryetari i Komunës.....	39
2.3Dominimi i fuqisë së Kryetarit të komunës në strukturën e kompetencave komunale.....	42
2.4Raportet midis pushtetit qendror dhe lokal.....	45
2.5Demokracia lokale dhe transparenca.....	47
2.5.1Iniciativa qytetare.....	47
2.5.2Tubimi i qytetarëve.....	47
2.5.3Referendumi.....	48
2.6Mbrojtja juridike kushtetuese e autonomisë lokale në RMV.....	50
KAPITULLI I TRETË	52
KAPACITETET E DECENTRALIZIMIT DHE TRANSPRENCËS SË KOMUNËS SË STUDENIÇANIT-STUDIM RASTI	52
3.1 Struktura territoriale dhe historiku i Komunës së Studeniçanit.....	52
3.2 Profili i Komunës së Studeniçanit.....	55
3.2.1 Kryetari i Komunës.....	55
3.2.2 Këshilli i Komunës.....	56
3.2.3 Administrata komunale.....	61
3.2.4 Ndërmarrjet dhe institucionet publike.....	65
3.2.5 E-Komuna: Buxhetet e komunës (2017-2020) dhe llogaritë përfundimtare të komunës.....	68
3.2.5.1. Analiza financiare për Buxhetin e Komunës së Studeniçanit 2017-2020.....	74
3.3 Analiza juridike-empirike e transparencës së Komunës së Studeniçanit.....	75
3.3.1 Anketimi dhe Intervistimi i qytetarëve të Komunës.....	76
3.3.2 Anketimi dhe Intervistimi i zyrtarëve komunal	77
3.3.3 Intervista me Kryetarin e Komunës.....	78
KONKLuzionET	81
SHTOJCA	86
BIBLIOGRAFIA	87

Abstrakti

Ky hulumtim ndërlidhet kryesisht me pushtetin lokal, si njësi e vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht, hulumtimi bazohet mbi dhënien e një pasqyre sa më konkrete të organizimit dhe funksionimit të Komunës së Studeniçanit, e cila shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë së Veriut në Shkup. Në këtë punim, do të mundohemi të gjejmë shkaqet që ndikojnë në njësinë e vetëqeverisjes lokale, kryesisht në Komunën e Studeniçanit dhe të gjejmë forma të reja të organizimit, si dhe faktorët të cilët ndikojnë në funksionimin e drejtë të kësaj komune. Qëllimi i këtij punimi është më tepër praktik se sa teorik duke pasur parasysh se theksimi i disa çështjeve me rëndësi si bashkëpunimi ndërkombëtar si dhe marrëdhëniet ndërmjet Komunës së Studeniçanit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut por edhe më gjërë do të jetë objekti kryesor i këtij punimi, kuptohet gjithmonë brenda kompetencave të komunës së përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe të cilët janë pjesë e rendit të brendshëm juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pra, me një fjalë punimi mëton të tregojë mbi qëllimin e bashkëpunimit, fushën dhe kompetencën për të cilën janë paraqitur, transparenca e kësaj komune, implikimet e mundshme financiare dhe përfitimet e një bashkëpunimi të tillë si dhe çështje tjera me rëndësi për krijimin e bashkëpunimit ndërkombëtarë. Në punim, të dhënat gjithashtu do të jenë të prezantuara në mënyrë tabelare si dhe me statistika të ndryshme, kështu duke dhënë për lexuesit një pasqyrë sa më të qartë dhe më konkrete mbi Komunën e Studeniçanit.

Fjalët kyçe: Komuna e Studeniçanit, transparenca, organizimi, kompetenca, bashkëpunimi, financat;

Апстракт

Ова истражување главно се однесува на локалната управа, како единица на локалната самоуправа, имено, истражувањето се заснова на давање поконкретен преглед на организацијата и функционирање на Општина Студеничани, која се наоѓа на северниот дел на Северна Македонија во Скопје. Во овој труд, ќе се обидеме да ги пронајдеме причините што влијаат на единицата на локална самоуправа, главно во Општина Студеничани и да се пронајдат нови форми на организација, како и факторите кои влијаат на правилното функционирање на оваа општина. Целта на овој труд е повеќе практична отколку теоретска со оглед на тој акцент на некои важни прашања како што се меѓународната и меѓопштинската соработка, транспарентноста, како и односите помеѓу Општина Студеничани и Владата на Република Северна Македонија но и повеќе широк ќе биде главниот предмет на овој труд, секогаш разбран во рамките на надлежностите на општината дефинирана со закон и со меѓународни договори ратификувани со закон и кои се дел од внатрешниот правен поредок на Република Северна Македонија. Значи со еден

збор има за цел да ја посочи целта на соработката, полето и компетентноста заради што се презентирани потенцијалните финансиски импликации и придобивките од таквата соработка како што се и други прашања релевантни за воспоставување на меѓународна соработка. Во трудот, податоците исто така, ќе бидат презентирани во табеларна форма, како и со различни статистички податоци, на тој начин давајќи им на читателите појасен и поконкретен преглед на Општина Студеничани.

Клучни зборови: Општина Студеничани, транспарентност, надлежности, соработка, финансии;

Abstract

This research is mainly related to local government, as a unit of local self-government, i.e., the research is based on giving a more concrete picture of the organization and functioning of the Municipality of Studenicani, which lies in the northern part of North Macedonia in area of Skopje. In this paper, we will try to find the causes that affect the local self-government unit, mainly in the Municipality of Studenicani and find new forms of organization, transparency, as well as factors that affect the proper functioning of this municipality. The purpose of this paper is more practical than theoretical, given that the emphasis on some important issues such as international and inter-municipal cooperation and relations between the Municipality of Studenicani and the Government of the Republic of North Macedonia and beyond will be the main object of this study is always understood within the competencies of the municipality defined by law and by international agreements ratified by law and which are part of the internal legal order of the Republic of North Macedonia. So, in one word, the paper aims to show the purpose of cooperation, the field and competence for which they are presented, the possible financial implications and benefits of such cooperation as well as other important issues for the establishment of this cooperation and transparency. In this study, the data will also be presented in tabular form as well as with different statistics, thus giving the reader a clearer and more concrete picture of the Municipality of Studenicani.

Keywords: Studenicani Municipality, transparency, organization, competence, cooperation, finance;

HYRJE

Qeverisja lokale është një kategori e sistemit kushtetues dhe politik të një vendi, por nuk ka të njëjtin pozicion dhe kuptim në të gjitha shtetet në të cilat ekziston. Si rezultat i kësaj, përkufizohet ndryshe nga autorë të shumtë në literaturën kushtetues juridike. Qeverisja lokale është një bashkësi territoriale në të cilën njerëzit së bashku, me forcat e përbashkëta, përpiqen në çdo mënyrë të mundshme të zgjidhin problemet me të cilat përballen dhe ta bëjnë jetën e tyre shumë më të thjeshtë. Në fakt, vetë qytetarët në mënyrë të pavarur, direkt ose përmes organeve të tyre përfaqësuese vendosin për ato çështje që kanë interes publik dhe rëndësi lokale. Qeverisja lokale përbëhet nga popullsia lokale në një komunitet që zgjedh autoritetet lokale dhe u jep atyre mbështetje të plotë, por në kthim pret që qeverisja lokale të zgjidhë problemet me të cilat përballen çdo ditë ose në baza të përbashkëta. Autoritetet lokale, nga ana tjetër, kanë burime të caktuara financiare për kryerjen e veprimtarive që janë në kompetencën e tyre, dhe janë në interes të vetë qytetarëve. Sidoqoftë, nëse pyesim veten nëse qeveria e shtetit mund të menaxhojë zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, apo nevojitet një funksionim dhe veprim i një qeverisje tjetër, përgjigjja do të ishte që autoritetet shtetërore nuk mund të mbulojnë tërë territorin, por atyre u duhet një qeverisje tjetër alternative ndaj së cilës do të transferohen disa nga kompetencat që ata do ti kryejnë, dhe në të cilat shfaqen disa dobësi funksionale, d.m.th. ku mund të paraqiten punë joefikase. Kjo do të thotë që në disa pjesë të zhvillimit shoqëror ka nevojë të prezantohet qeverisja tjetër alternative, përkatësisht ajo lokale për të cilën do të flasim në këtë Tezë të MA. Pushteti lokal ka një aftësi të madhe dhe mund të përshtatet me karakteristikat specifike të një zone dhe të japë përparësi dhe kontribute për ato çështje më të rëndësishme për qytetarët, sesa që mund këtë ta bëjë qeveria e shtetit, nëse i kryen të njëjtat përgjegjësi sikurse pushteti lokal.

1. Qëllimet e hulumtimit

Arsyet përse e kam zgjedhur këtë temë për tezë të magjistraturës kanë të bëjnë me faktin se organizimi dhe funksionimi i sistemit në nivelin e qeverisjes lokale-pushtetit vendor, është i rëndësishëm për çdo shtet, e në veçanti për shtetet me sistem bashkëkohor demokratik. Për një kohë të gjatë, por edhe aktualisht, kjo është fushë interesimi i shumë teoricienëve të ndryshëm, e në rend të parë për konstitucionalistët dhe politologët. Në pjesën më të madhe të shteteve dhe në teorinë shkencore, trajtimi i konceptit të qeverisjes lokale është sinonim i autonomisë lokale, përkatësisht qeverisjes në nivelin e njërive të organizimit territorial të këtij pushteti pa prerogativa të pushtetit shtetëror, domethënë është organizimi i pushtetit në nivelin e komunës, bashkisë, rajonit, qytetit, provincës. Pa marrë parasysh rregullimin politik, ky nivel i organizimit të pushtetit dhe funksionimi i tij është pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm politik e çdo shteti, si dhe organizohet në të gjitha shtetet.

Disa nga shtetet më të zhvilluara të Evropës Perëndimore gëzojnë tashmë një kulturë shumëshekullore në sistemin e vetëqeverisjes lokale. Këto shtete janë pikërisht ato, që kanë krijuar sistemin shumëpartiak parlamentar demokratik, si dhe atë të qeverisjes lokale në parimet demokratike. Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe ato të Ballkanit Perëndimor ku bën pjesë edhe Maqedonia e Veriut, organizimin dhe ndërtimin e këtij niveli të pushtetit në parimet demokratike e filluan pas ndryshimeve të mëdha, që ndodhën në fund të shek. XX. Pra, me ndryshimet strukturore në rrafshin politik, ideologjik, ekonomik, kulturor dhe social, duke kërkuar rrugë dhe alternativa decentralizuese të këtyre sistemeve. Kështu, me ndryshimet kushtetuese, të akteve e ligjeve të veçanta mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale-pushtetit vendor, këto shtete përqafuan parimet demokratike evropiane në tërë korpusin politik e në veçanti parimet që dalin nga Karta Evropiane për Qeverisjen Lokale “European Charter of Local Self- Government”, e miratuar nga Këshilli i Evropës më 1985, në Strasburg të Francës.

Me ratifikimin e Kartës Evropiane për Qeverisjen Lokale, çështja e organizimit, e funksionimit dhe e kompetencave të njërive të qeverisjes lokale i tejkaloi kornizat e sistemit të brendshëm të vendit të caktuar. Përcaktimi kushtetues dhe rregullimi ligjor i këtij sistemi tani nuk mund të konsiderohet si e drejtë ekskluzive e sistemit të brendshëm politik, apo si çështje e

brendshme e një vendi, duke marrë në konsideratë edhe faktin, që, tani, ky sistem përmban edhe premisa ndërkombëtare.

Sistemi i qeverisjes lokale nuk është një koncept abstrakt, por konkret dhe publik, i cili bazohet dhe ndërtohet mbi faktorë përcaktues për organizimin dhe funksionimin e një njësie të vetëqeverisjes lokale, siç janë: territori i caktuar, konfiguracioni gjeografik dhe qytetarët.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të parashtojë dhe të shtjellojë në mënyrë teorike dhe empirike konceptin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në RMV si dhe të ofrojë zgjidhjet normative (ligjore) të kapaciteteve decentralizuese në RMV si dhe të transparencës në punën e qeverisjes lokale, me vështrim të posaçëm në Komunën e Studeniçanit.

Ky hulumtim mund t`u shërbejë edhe autoriteteve lokale dhe qendrore, si bazë e mirë teorike dhe empirike për të kuptuar drejtë rolin e tyre kushtetues dhe ligjor, që kanë në mes tyre, si dhe në raport me qytetarët në përgjithësi për zhvillimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale.

2. Hipotezat

Gjatë këtij hulumtimi shkencor do të paraqesim disa hipoteza, të cilat gjatë përpunimit të tezës do të vërtetohen.

Hipotezat e punimit janë:

Hipoteza gjenerale:

- Qeverisja lokale në RMV me procesin e decentralizimit, ka fituar kompetenca të shtuara në rrafshin lokal

Hipotezat e veçanta:

- Cila është korniza normative (kushtetuese, ligjore dhe statutare) e transparencës së qeverisjes lokale në RMV, në veçanti e Komunës së Studeniçanit
- Rritja e transparencës së Qeverisjes lokale, në veçanti e Komunës së Studeniçanit, e rrit besimin e qytetarëve në institucionet e saj
- Cili është niveli i publikimit të të dhënave të sektorit publik në rrafshin lokal në Komunën e Studeniçanit
- Në përgjithësi Komuna e Studeniçanit ofron një transparencë të pjesshme, llogaridhënie minimale, me mundësi të kufizuara të komunikimit elektronik interaktiv me qytetarët

3. Metodologjia e hulumtimit

Për kryerjen e studimit do të përdoren metodat si vijon:

- Metoda historike;
- Metoda krahasuese;
- Metoda e studimit të rastit;
- Metoda juridike;
- Metoda statistikore;

Në elaborimin e kësaj teme do të shfrytëzohen të dhëna të ndryshme nga institucionet relevante në vend si dhe të publikimeve të ndryshme, revistave si dhe burimeve tjera juridike.

4. Rëndësia e punimit

Pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin e politikave lokale dhe aftësia për të ndikuar në formësimin dhe përmirësimin e vendimeve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës në komunitetin lokal janë parakushtet kryesore për qeverisjen demokratike në nivelin lokal. Në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin pjesë me iniciativat dhe propozimet e tyre, qytetarët duhet të jenë në gjendje të përdorin lirshëm të dhënat dhe informacionet dhe t'i shpërndajnë ato me qytetarët e tjerë. Roli i autoriteteve dhe administratës vendore në këtë proces të ndërtimit të dialogut politik të hapur dhe pjesëmarrës përfshin gjetjen e qasjeve inovative që do të forcojnë përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës në vendimmarrje që, nga ana tjetër, parasheh politika më të mira, stimulon vendime dhe mbështetje nga komuniteti në zbatimin e tyre. Nga ky kontekst i proceseve demokratike në krijimin e politikave lokale, në realitetin konkret të shoqërisë në RMV lindin dy pyetje thelbësore: (1) sa pushteti vendor dhe administrata lokale përmes të dhënave dhe informacionit që kanë, janë të hapura për të ndikuar në interesat e shoqërisë; (2) cilat të dhëna dhe informacione u duhen qytetarëve për ta arritur atë ndikim, ndërsa monitorojnë se çfarë prodhon politika, d.m.th. nëse politikat lokale përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe në çfarë mase?

Sigurisht, sot, përpjekjet për të modernizuar qeverisjen lokale, dhe duke përfshirë qytetarët në ndërtimin e politikave dhe shërbimeve më efikase, duhet të marrin parasysh mënyrat novatore të komunikimit të imponuara nga zhvillimi i teknologjive të informacionit, në krahasim me mekanizmat tradicional të këshillimit dhe komunikimit me qytetarët.

Transparenca, përgjegjësia-llogaridhënia dhe pjesëmarrja e qytetarëve në një demokraci moderne duhet të mundësojnë që impulset dhe idetë e jashtme të merren parasysh gjatë zgjidhjes së problemeve komplekse në shoqëri. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje e bën sistemin kushtetues të vendit më demokratik dhe gjithëpërfshirës. Kjo qasje inkurajon iniciativën e qytetarëve për mobilizimin dhe përfshirjen në procesin politik dhe rivendosjen e besimit tek institucionet. Për administratën, kjo do të thotë mundësi më të mëdha për kapacitetet institucionale që mund të sjellin ndryshime të rëndësishme në të ardhmen.

KAPITULLI I PARË DECENTRALIZIMI I QEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKEN E MAQEDONISË SË VERIUT

1.1 Kuptimi i qeverisjes lokale

Në fillim të shqyrtimeve janë te nevojshme disa njohuri të përgjithsme për kuptimin e sistemeve të qeverisjes dhe të procesit historik të zhvillimit të tyre. Përvetësimi i termit qeverisje në rast të parë ka rëndësi të veçantë. Ricard Hardly, sistemin e qeverisjes e percaktonte si bashkrendim të katër komponentëve përbërës ndër këto komponente ai theksonte popullin, pa të cilin nuk mund të ketë qeverisje, territorin” në të cilën jeton ai popull, vetë qeverisjen dhe sovranitetin. Për shkak të mundësisë së ngatërimit të termeve që ndodh në praktikë vlen që në fillim të shqyrtimeve të bëhet dallimi midis termeve “qeveri dhe qeverisje”. Qeveria ka “kuptimin e ushtrimit të pushtetit ekzekutiv dhe ky është kuptimi më i përgjithshëm i saj. Në fakt qeveria krijohet nga një forcë ose forca politike të caktuar dhe ajo si rregull mban vulën e kryeministrit dhe emërtohet me emrin e tij. Ndërsa, qeverisja është kuptim më i gjërë se qeveria. Qeverisja shtrihet në tri hallka ose degëzime të cilat janë të pranishme në të gjitha sistemet. Shqyrtimet për qeverisjen po marrin përmasa gjithnjë e më të mëdha. Në të vërtetë ato po pretendojnë në gjërësi, qoftë në thellsi të përfshinë elementet dhe çështjet që i referohen¹.

1. Organizimit të qeverisjes,
2. Funksionimit të qeverisjes
3. Kontrollit të punës së organeve dhe organizatave në sistemin e qeverisjes.

Kur bëhet fjalë për organizimin e qeverisjes si element përbërës i objektit të shkencës mbi qeverisjen, një numër i madh pyetjesh kerkojnë përgjigje. Pikësëpari është e nevojshme që të bëhet fjalë për teorinë e sistemit të qeverisjes. Për këtë qëllim duhet sqaruar nocionin e sistemit dhe të nënsistemit, natyrisht dhe parimet e tyre si dhe klasifikimin që nenkupton llojet dhe strukturën e teorive të sistemit. Në kuader të organizimit të qeverisjes, një vend të merituar duhet të ketë teoria e organizatës. Fillimisht do të jepet nocioni i organizatës, ku do të paraqiten pikepamjet e ndryshme mbi këtë nocion sado të qartësuar por ende të

¹ Për më tepër shih në: Agni Aliu dhe Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Prishtinë, 2009, fq. 17.

diskutueshëm. Do të bëhet fjalë për mundësitë e klasifikimit të organizatës si dhe të elementeve të saj natyrisht se nuk do të ngelin anash as parimet e organizatës.

Qeverisja përbehet nga një numër i madh i aksioneve qeverisëse dhe zbatimi i atyre aksioneve. Qeverisja është e domosdoshme jo vetëm për funksionimin normal të sistemit por edhe për sigurimin e zhvillimit të tij². Në bazë të elementeve që e përkufizojnë qeverisjen mund të nxirret si përfundim se kur bëhet fjalë për qeverisjen mendohet për të gjitha ato aktivitete që domosdo duhet të ndererren për realizimin e qëllimeve përkatëse në një organizatë ose shoqëri në përgjithësi. Qeverisja zbatohet në sisteme të ndryshme dhe ky është shkaku për të konstatuar se ajo mund të vështrohet në dy kuptime të veta themelore, edhe atë: qeverisja në kuptimin e gjërë dhe qeverisja në kuptimin e ngushtë.

Shqyrtimet përqendrohen në kuptimin e gjërë të qeverisjes kuptim ky që mund të zbërthehet në:

1. Qeverisjen territoriale, me organizimin e ndryshëm dhe shkallë ndryshme;
2. Qeverisjen funksionale me organizimin e ndryshëm dhe në fusha të ndryshme të jetës;
3. Qeverisjen asociative mikste ose paternaliste;

Ndërkaq, qeverisja në kuptimin e ngushtë shtrihet në proceset përkatëse të punës dhe ajo nuk paraqet objekt të shqyrtimeve tona. Vëmendje e veçante i kushtohet qeverisjes territoriale e cila paraqet një proces shumë të përbërë nga më shumë funksione përkatësisht veprimtari të ndryshme.

Sipas autorëve përfundimor ekzistojnë tri veprimtari themelore të shtetit të cilat i përmbledh procesi i qeverisjes dhe ato janë:

1. Veprimtaria legjislativë
2. Veprimtaria ekzekutive
3. Veprimtaria gjyqësore

Ka autorë që bëjnë fjalë edhe për “veprimtarinë administrative”. Tre veprimtari themelore të shtetit mund të zbërthehen si numër edhe në më shumë veprimtari përkatësisht funksione ku si rregull bëhet fjalë për këto funksione:

² Për më tepër shih në: Agni Aliu dhe Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Prishtinë, 2009, fq. 18.

Funksioni politik, funksioni ekzekutiv, funksioni administrativ, funksioni gjyqësor dhe funksioni i ndjekjes publike, me çrast në pika të sublimuara do ti theksojmë disa nga karakteristikat e secilit nga keto funksione.

Funksioni politik i shtetit është në fakt funksion i caktimit të politikës dhe ky funksion buron nga funksioni ligjvënës sepse perbëhet nga nxjerrja e vendimeve themelore me të cilat caktohet qellimi i aksionit të njesisë territoriale të caktuar. Ato vendime shprehen në formë të akteve kushtetuese, ligjore dhe të akteve të tjera³.

Veprimtaria ekzekutive në kuptimin e përgjithshëm është një dhe e vetme mirëpo si veprimtari komplekse perbëhet nga kujdesi për realizimin e politikës të cilën e ka përcaktuar organi legjislativ, zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera të këtij organi si dhe nga përcaktimi dhe drejtimi i punës së organeve të administratës.

Funksioni administrativ buron nga funksioni ekzekutiv ku në të vërtetë ky funksion shprehet si funksioni ekzekutiv.

Aktiviteti ekzekutiv i administratës manifestohet me zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera të organit legjislativ nepermjet akteve të administratës si dhe ushtrimit të veprimtarisë represive. Mbikëqyrja administrative shprehet si mbikëqyrje instancionale, mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e punës së organizmave jo shtetërore dhe si mbikëqyrje inspektive.

Veprimtaria gjyqësore shtrihet në zgjidhjen e konflikteve të cilët shfaqen me rastin e konkretizimit dhe të zbatimit të vendimeve themelore me të cilat përcaktohet politika e njesisë territoriale të caktuar, ku ky funksion ju besohet organeve të specializuara. Veprimtaria e ndjekjes publike shtrihet në ndërrmarjen e masave përkatëse për mbrojtjen e interesave të njesisë territoriale të caktuar dhe për përdorimin e mjeteve juridike me qëllim të mbrojtjes së kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë.

Shqyrtimet për qeverisjen përgjithësisht barten natyrshëm mbi qeverisjen lokale që paraqet objekt studimi në këtë punim ku sipas fjalorit politik të Oksfordit, qeverisja lokale ose vendore është një institucion qeverisës që ushtron autoritetin në një zonë teritorialisht të përcaktuar të vendit.

³ Për më tepër shih në: Agni Aliu dhe Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Prishtinë, 2009, fq. 19.

Me gjithë këtë perkufizim të përgjithshëm të qeverisjes lokale ekzistojnë pikëpamje të ndryshme rreth përcaktimit të qeverisjes lokale ku problemet janë edhe të natyrës metodologjike, andaj shqyrtimet në këtë punim do të përqëndrohen edhe në çështje të terminologjisë⁴.

Megjithë pikëpamjet e ndryshme që shpesh në perkufizimet e qeverisjes lokale ato mund të përmbliken në disa nga faktorët më dominantë që mund të ndihmojnë të krijohet një kuptim më i përgjithësuar i qeverisjes lokale, edhe atë:

1. Meqë parimet e qeverisjes lokale përmbliken në aktet kushtetuese, qeverisja lokale padyshim paraqet kategori të së drejtës kushtetuese.

2. Qeverisja lokale nënkupton të drejtën e qytetarëve që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të mëvetësishme të vendosin çështjet me interes për njësinë e vetë territoriale.

3. E drejta e qytetarëve shtrihet në zgjidhjen dhe kontrollin e institucioneve të veta lokale.

4. Organet lokale gëzojnë kompetencat e veta.

5. Marrëdhëniet e institucioneve të qeverisjes lokale me pushtetin qendror karakterizohen me kontrollin e tij të ligjshmërisë së punës së institucioneve lokale.

6. Njësia e qeverisjes lokale disponon me mjetet e veta dhe të drejtën e destinimit të tyre.

Prandaj duhet potencuar se, nuk ka një perkufizim të qeverisjes lokale të pranueshëm për të gjithë. Edhe në legjislacionet e vendeve të ndryshme hasim në perkufizimet e nocioneve të veçanta në mënyrë që të mësohet domethënia dhe kuptimi i tyre⁵.

Pra, në kuptimin më të përgjithshëm qeverisja lokale si mision dhe synim ka sigurimin e qeverisjes në një nivel sa më afër të qytetarëve. Misioni i pushtetit lokal shpërfaqet në formë të ndryshme si respektim i të drejtave themelore të qytetarëve të sanksionuara në kushtetutë ose në ligje, zgjedhja e llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike lokale, ushtrimi efektiv i funksioneve kompetencave dhe realizimi i detyrave nga organet e qeverisjes

⁴ Për më tepër shih në: Agni Aliu dhe Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Prishtinë, 2009, fq. 20.

⁵ Ibid, fq. 23.

lokale, realizimi i shërbimeve në formë të përshtatshme, nxitja efektive e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen lokale, etj⁶.

Studimi i nocionit të vetëqeverisjes lokale ishte një ndër problemet më të vështira të së drejtës kushtetuese në tërësi, e në veçanti të teorisë dhe praktikës të sistemit politik të një shteti. Disa autorë dhe studiues të çështjeve të qeverisjes lokale kanë hasur vështirësi në përkufizimin e këtij nocioni për shkak të kushteve të ndryshme të paraqitjes, krijimit dhe formimit të këtij institucioni politik në shtete me sisteme të ndryshme shoqërore e politike. Pikëpamjet e ndryshme politiko-filozofike dhe ideore mbi vendin, rolin dhe rëndësinë e këtij sistemi, e sidomos me faktin se ekzistojnë edhe sot mospajtime jo vetëm teorike, por edhe terminologjike, kanë influencuar në mungesën e një përkufizimi të plotë të vetëqeverisjes lokale. Mospajtimet terminologjike për këtë institucion janë shkaktuar edhe për vetë faktin se disa dukuri të ndryshme kanë pasur të njëjtin emërtim. Studiues të ndryshëm në krijimin e përkufizimit të nocionit të vetëqeverisjes lokale bazohen në ndarjen territoriale, ndërsa disa të tjerë nisen nga karakteristika, e ashtuquajtur interaksioni shoqëror, në kuptimin e veprimit reciprok dhe veprimit të varur reciprok të qytetarëve (qytetarët, aktivitetet, nevojat dhe marrëdhëniet). Si rrjedhojë, për përkufizimin dhe kuptimin e nocionit të vetëqeverisjes lokale, përveç vështirësive esenciale kuptimore, duhet pasur parasysh edhe dallimet terminologjike, të cilat burojnë nga ato të vetkuptimit të këtij nocioni⁷.

Studiues të ndryshëm, të cilët kanë si synim analizimin e formave dhe të modeleve të qeverisjes lokale, kanë përcaktuar dhe elementet themelore të këtij nocioni. Kështu, sipas Reidlich, një nga studiuesit më të njohur të pushtetit lokal anglez, konkludon se në Angli nuk ekziston shprehje e vetëqeverisjes lokale, por sundim-pushtet lokal, administratë-administrim, në kuptim të gjerë. Ai pohon se: "Qeverisja lokale paraqet realizimin e vendimit nga ana e qytetarëve, përkatësisht përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, të funksioneve dhe autorizimeve, të cilat i ka përcaktuar legjislatori, ose që u takojnë në bazë të së drejtës së përgjithshme" (Reidlich, J,1972 :46). W. Robson, një ndër politologët dhe studiuesit e njohur, i cili është marrë posaçërisht me problemet e vetëqeverisjes lokale, në enciklopedinë e

⁶ Për më tepër shih në: Agni Aliu dhe Esat Stavileci, Qeverisja lokale, Prishtinë, 2009, fq. 23.

⁷ Për më tepër shih në: Ramiz Fazliu, Vetëqeverisja lokale, modelet, organizimi dhe funksionimi-Rasti i Kosovës, Disertacion i doktoratës, UET-Tiranë, 2016, fq. 25.

shkencave sociale ka dhënë karakteristikat e përgjithshme të vetëqeverisjes lokale (të pushtetit). Sipas tij, pushteti lokal është një bashkësi territoriale, josovrane, e cila ka bazën ligjore mbi të cilën janë të përcaktuara të drejtat dhe mënyra e organizimit të saj. Pra në pushtetin lokal duhet të ekzistojnë organet ligjore të autorizuara për administrimin e politikave territoriale, pavarësisht nga kontrolli i jashtëm, si dhe pjesëmarrja e bashkësisë lokale në udhëheqjen e punëve të veta. (Robson, W. Encyclopedia of the Social Sciences, 1990:47). Sipas W. Anderson, një nga studiuesit më të rëndësishëm të vetëqeverisjes lokale amerikane, pushteti lokal është i karakterizuar nga elementë si: 1. territori; 2. banorët; 3. organizimi; 4. identiteti i veçantë juridik; 5. autonomia; 6. funksionet e vetëqeverisjes 7. pavarësia fiskale. (Anderson, W. 1945:47)⁸.

Studiuesi Hans Peters në veprën e tij “Manuali mbi shkencën komunale dhe praktikën”, duke u mbështetur në disa qëndrime themelore të sistemit të vetëqeverisjes lokale angleze, përcakton se elementët, që karakterizojnë sistemin e vetëqeverisjes gjermane janë: 1. Detyrat e përbashkëta publike, 2. Përgjegjësia e vet, 3. Qeverisja në emër të vet, 4. Personi juridik i bashkësisë, 5. Organet e veta të zgjedhura, 6. Inkorporimi në shtet dhe 7. Mbikëqyrja e shtetit. (Peters. H, 1956:47)⁹.

Siç potencon Fazliu, pasi analizojmë të gjitha përkufizimet e mësipërme të dhëna nga studiuesit e lartpërmendur, ku vërehen edhe karakteristika të përbashkëta për qeverisjen dhe strukturën e qeverisjes në bashkësitë themelore lokale dhe në njësitë administrative-politike, arrijmë të japim një përkufizim të përgjithshëm të vetëqeverisjes lokale në kuptimin e gjerë të saj. Vetëqeverisja lokale është kategori e së drejtës kushtetuese, e sistemit politik dhe është pjesë e administratës shtetërore. Në harmoni me këto, ajo është trajtë politike e bashkësisë lokale dhe trajtë e qeverisjes për kryerjen e shërbimeve publike në shoqëri¹⁰.

Si vendlindje e qeverisjes lokale konsiderohen: Mbretëria e Bashkuar, Zvicra dhe SHBA-të. Në Mbretërinë e Bashkuar, qeverisja lokale ekziston paralelisht me pushtetin qendror me atë dallim që, në kuadër të bashkësisë lokale ekzistojnë vetëm organe të QL-së pa njësi rajonale

⁸ Për më tepër shih në: Ramiz Fazliu, Vetëqeverisja lokale, modelet, organizimi dhe funksionimi-Rasti i Kosovës, Disertacion i doktoratës, UET-Tiranë, 2016, fq. 26-28.

⁹ Ibid.

¹⁰ Ibid.

të pushtetit qendror. Kompetencat e tyre i përcakton parlamenti. QL-ja në këtë vend është tri shkallëshe: famullitë (parishes), rrethet (districts) dhe qarqet (counties)¹¹. Në Zvicër, QL-ja rregullohet me ligjet kantonale dhe është kryesisht njëshkallëshe edhe pse ka kantone me QL dyshkallëshe. Zvicra ka një traditë të gjatë të QL të drejtpërdrejtë, me ç'rast vendimet e këshillave lokalë i nënshtrohen referendumit të detyrueshëm ose fakultativ. Në mbi 90% të komunave ende ekzistojnë kuvendet komunale, si tubime të qytetarëve madhorë (landsgemeinde), ku qytetarët shqyrtojnë dhe vendosin për çështjet kryesore me rëndësi lokale¹². Edhe në SHBA në qytetet e vogla në pjesën veriore ende ekzistojnë tubimet e qytetit (town meetings) ku njëherë në vjet tubohet popullsia e gjithëmbarshme e qytetit dhe drejtpërdrejtë i zgjedh këshilltarët dhe zyrtarët komunalë. QL-ja në SHBA është më e ndërlikuara në botë sepse sipas Kushtetutës së SHBA-ve, QL-ja është në kompetencë të njësive federative, e jo të Federatës¹³.

1.2 Koncepti kushtetues i qeverisjes lokale në RMV

Qeverisja lokale në RMV paraqet materie kushtetuese, meqë Kushtetuta e RMV-së, qeverisjen lokale e përcakton si vlerë themelore të rendit kushtetues si dhe i kushton një kapitull të tërë këtij lëmi, edhe atë kapitullin e pestë (dispozitat e neneve 114-117), ku përcaktohet pozita kushtetuese e qeverisjes lokale në sistemin politik të vendit. Kushtetuta përcakton se, qytetarëve u garantohet e drejta e qeverisjes lokale. Njësitë e qeverisjes lokale janë komunat dhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë, ku mund të themelohen forma të qeverisjes vendore. Komunat dhe Qyteti i Shkupit financohen nga burimet vetanake nga të hyrat e caktuara me ligj dhe me mjete nga Republika. Ndërkaq, me Amendamentin XVI të v. 2001 për Kushtetutën e RMV-së përcaktohet se, qeverisja lokale rregullohet me ligj që miratohet me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë edhe shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë komuniteteve joshumicë në RMV, ku siç shihet qëllimi i kushtetutëvënësit është që, të mbrohet qeverisja lokale nga majorizimi etnik dhe voluntarizmi politik i ndërhyrjes së ligjvënësit

¹¹ Për më tepër shih në: Радивоје Маринковић, Локална самоуправа, Београд, 1968, стр. 88.

¹² Për më tepër shih në: Ђурђевић Др., Александар, Локална самоуправа, Нови Сад, 1997, стр. 45.

¹³ Për më tepër shih në: Поповић Др., Славољуб, Регионализација у свету и код нас, Београд, 1983, стр. 86, dhe: Марковић Др., Ратко, Уставно право и политичке институције, „Службени гласник“, Београд, 1995, стр. 507-508.

në sferën lokale të qytetarëve. Ligjet për financimin lokal, zgjedhjet lokale, kufijtë komunal dhe për Qytetin e Shkupit, miratohen me shumicën e votave nga deputetët e pranishëm, me ç'rast duhet të sigurohet edhe shumica e votave të deputetëve të pranishëm të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në RMV. Nga ana tjetër, me Amendamentin XVII pika 1 të v. 2001 për Kushtetutën e RMV-së, që rregullon kompetencat e qeverisjes lokale, përcaktohet se, në njësitë e saj, qytetarët drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështjet me rëndësi lokale, e veçanërisht në lëmenjtë e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit ekonomik lokal, financimit lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe në lëmenjtë e tjerë të caktuar me ligj, me çrast përcaktimi kushtetues i kompetencave të qeverisjes lokale nuk është përfundimtar dhe mund të plotësohet edhe me ligje. Poashtu, me Amendamentin XVII pika 2 të v. 2001 për Kushtetutën e RMV-së rregullohen kompetencat e Qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e qeverisjes lokale, dhe përcaktohet se në Qytetin e Shkupit, qytetarët drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështjet me rëndësi lokale, e veçanërisht në lëmenjtë e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit ekonomik lokal, financimit lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe në lëmenjtë e tjerë të caktuar me ligj¹⁴.

Pra, lidhur me konceptin kushtetues të qeverisjes lokale në RMV, mund të rezimohet se, Kushtetuta e RMV-së:

- Garantoni të drejtën e qytetarëve për qeverisje lokale;
- Themelon komunitat si njësi të qeverisjes lokale;
- Parashikon që format e qeverisjes vendore mund të vendosen brenda komunave;
- Garantoni autonominë e komunave në kryerjen e kompetencave, të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj;
- Garantoni që komunitat të kenë burime financiare, si dhe financim nga shteti;

¹⁴ Për më tepër shih në: Shasivari Dr. Jeton, E drejta kushtetuese, botimi i dytë, Shkup, 2020, fq. 316-317 dhe Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, nenet 114-117 (Teksti jo-zyrtar, i spastruar-për përdorim intern), përkthyer nga: Prof. Dr Kurtesh Saliu, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë, 2007, fq. 45-46.

- Promovon demokracinë lokale të drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese;
- Përcakton Qytetin e Shkupit si njësi të veçantë të qeverisjes lokale, organizimi i të cilit rregullohet me ligj të veçantë¹⁵.

1.3 Koncepti ligjor i qeverisjes lokale në RMV

Ligji aktual për qeverisjen lokale është miratuar nga Kuvendi i RMV-së më 24 janar të v. 2002, mirëpo përgatitja e tij ka filluar qysh në v. 1998 me inkorporimin për here të parë të Ministrisë së Qeverisjes lokale. Me këtë ligj rregullohen: kompetencat e komunës; pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në marrjen e vendimeve; organizimi dhe puna e organeve të komunës; administrata komunale; aktet e organeve; prona e komunës; mbikëqyrja mbi punën e organeve të komunës; shpërndarja e këshillit të komunës; mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe Qeverisë së Republikës; qeverisja vendore; mbrojtja e qeverisjes lokale; përcaktimi i gjuhëve zyrtare në komuna dhe çështje tjera me rëndësi për qeverisjen lokale¹⁶.

Nga ana tjetër, siç potencon prof. Shasivari dominimi i kompetencave dhe i fuqisë së kryetarit të komunës (prefektit) në strukturën e kompetencave të qeverisjes lokale si dhe në qasjen e resurseve të tij, ndikoi në paraqitjen dhe përforcimin e një modeli të vërtetë të monopolit monokratik të pushtetit dhe të fuqisë në udhëheqjen e politikave lokale dhe në shfrytëzimin e resurseve publike të bashkësive lokale. Në periudhën kohore deri në vitin 2005 e, sot edhe më tepër, pothuajse krejt kompetencat dhe fuqia e qeverisjes lokale në RMV po përqëndrohet në pozicionin e kryetarit të komunës (prefektit). Prefekti përveç asaj që është funksionari i vetëm ekzekutivo-administrativ, ai merr pjesë edhe në funksionin normativ (“ligjvënës”) të bashkësisë lokale në atë mënyrë që është propozues i autorizuar i vendimeve të Këshillit të asaj bashkësie. Ai udhëheq me shërbimet profesionale dhe administratën e njësisë së qeverisjes lokale. Të punësuarit në ato organe drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të plotë varen nga prefekti. Ai vendos për të drejtat e personave juridikë dhe fizikë në procedurën

¹⁵ Për më tepër shih në: Davkova-Siljanovska, Dr., Gordana, “Legal and Institutional Framework of Local Self-Government in the Republic of Macedonia”, Lex Localis-Journal of Local Self-Government, Vol. 7, No. 2, 2009, p. 107-127.

¹⁶ Ligji për qeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e RMV-së”, nr. 5/2002, neni 1.

administrative. Prefekti i emëron dhe shkarkon drejtorët dhe organet e qeverisjes lokale. Ai e siguron shfrytëzimin dhe mbrojtjen e pronës së qeverisjes lokale. Prefekti është ekskluzivisht kompetent për përmbarimin (ekzekutimin) e vendimeve të Këshillit. Ai është kompetent edhe për përmbarimin e Buxhetit të njësisë së qeverisjes lokale, duke pasur kompetencë të plotë mbi politikën e përmbarimit dhe udhëheqjes me punët e qeverisjes lokale. Nga ana tjetër, prefekti, me asgjë nuk varet nga Këshilli i njësisë së qeverisjes lokale e, poashtu nuk varet me asgjë edhe nga qytetarët mbase për atë nuk është paraparë as impiçmenti e as revokimi. Pra, përderisa është gjallë dhe shëndosh e mirë dhe përderisa në kuptimin formalo-juridik u përmbahet ligjeve, gjë që është lehtë për t'u realizuar, atë askush nuk mund ta ndërrojë pa marrë parasysh se ai mund ta humb autoritetin dhe legjitimitetin e funksionarit publik (funksionarit që është në shërbim të interesave publike të qytetarëve dhe popullsisë lokale)¹⁷.

Përballë një pozicioni të tillë të prefektit, Këshilli i njësisë së qeverisjes lokale ka një pozicion ndjeshëm më të dobët. Këshilli miraton akte dhe vendime, duke rregulluar disa lëmi dhe çështje në mënyrë të përgjithshme me çka e normon kornizën e politikave lokale. Kuptohet se kjo gjë, paraqet një dimension mjaft të rëndësishëm për jetën dhe interesat e bashkësisë lokale dhe për funksionimin e qeverisjes lokale, mirëpo, determinimi i parë dhe kryesor i atyre akteve dhe vendimeve është propozimi i tyre, pra, përkufizimi i dispozitivit të vendimeve, argumentacionit dhe rezultatet e përmbarimit të tyre. Krejt këtë e përgatit dhe e siguron shërbimi profesional dhe administrata e qeverisjes lokale, ndërkaq, e verifikon, propozon dhe realizon prefekti. Pra, selektimi i mundshëm i prioriteteve dhe i argumenteve ndodhet në pushtetin dhe në fuqinë e prefektit. Në këtë drejtim, poashtu është e mundshme edhe konsekuenca e krejt kësaj shtate, që konsiston në selektimin e interesave duke mos i përfillur interesat e përgjithshme dhe të përbashkëta të bashkësisë lokale dhe të qytetarëve. Një gjë e tillë është më se reale, në kushte kur dominojnë interesat e veçanta partiake, klanore, kriminale apo të grupeve të biznesit, që paraqiten si një realitet në një numër të madh të rasteve brenda për brenda eksperiencës së këtij modeli të qeverisjes lokale në RMV. Në mënyrë plotësuese, mozaiku i tillë rrumbullakësohet më faktin se, vetë qytetarët janë subjekti më i dobët në

¹⁷ Për më tepër shih në: Shasivari Dr. Jeton, E drejta kushtetuese, botimi i dytë, Shkup, 2020, fq. 318 dhe Поповски, Др., Владо, "Локалната самоуправа во РМ", Годишник на Правниот факултет-Скопје во чест на Тодорка Оровчанец, Том 42, 2006, стр. 361-376.

konceptin e qeverisjes lokale në RMV. Qytetarët pas aktit të zgjedhjeve lokale nuk kanë kurfarrë pozicioni apo qasje në praktikimin e qeverisjes lokale. Institutet e demokracisë së drejtpërdrejtë, siç janë: iniciativat dhe tubimet e qytetarëve, janë modele tepër të dobëta për rolin e qytetarëve në qeverisjen lokale në RMV. Këto mekanizma janë difuze, shumë rëndë vihen në lëvizje dhe si një kapak i krejt kësaj, krejt ajo që mund të rrjedh si konkluzion i tyre, nuk është e detyrueshme për organet e qeverisjes lokale. Pra, çdo përpjekje e qytetarisë lokale varet nga konstatimi dhe vullneti i prefektit dhe këshillit të komunës. Krejt ky domen i participimit të qytetarëve në qeverisjen lokale paraqet një domen që ri i varur në ajër, pa mekanizma të duhura për ndikim efektiv ndaj organeve të qeverisjes lokale. Deri në vitin 2002, pra, deri me Ligjin e ri për qeverisjen lokale, qytetarët kishin mundësi që të votojnë lidhur me votëbesimin e prefektit, të cilin vetë e kanë zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta. Ky instrument paraqiste një mundësi për të provuar legjitimitetin e prefektit si dhe për të sendërtuar verifikimin demokratik të punës së tij nga aspekti i interesave të popullsisë lokale. Mirëpo, ky instrument, u shfuqizua me Ligjin aktual të vitit 2002, kështu që, sot, normativisht dhe praktikisht, është në fuqi pozicioni i paprekshëm i prefektit¹⁸.

Në duart e qytetarëve ka ngelur ende, referendumi me të cilin mund të ndikohet në organet e qeverisjes lokale për një çështje të caktuar. Mirëpo, ky instrument, aq rrallë është zbatuar sa që, i është harruar edhe emri dhe kuptimi. Edhe përkundër preferimit (rekomandimit) të tij si një praktikë dhe politikë e përgjithshme evropiane (sipas Kartës Evropiane për Qeverisje Lokale), referendumi lokal nuk arriti të nikoqirëzohet në qeverisjen lokale të RMV-së. Referendumin lokal nuk e zbatojnë edhe partitë politike në kuadër të politikave të tyre lokale, gjë që flet mjaft, për preferimin e rolit partiak përpara rolit të qytetarëve në kuadër të politikave lokale, gjë që paraqet edhe një indikator për disa dukuri të tjera. Për këto arsye, por, jo vetëm, funksioni i prefektit filloi të perceptohet si një funksion mjaft i kërkuar (i pëlqyer) dhe si një biznes profitabil e, jo si një funksion publik në interes të përgjithshëm të qytetarëve dhe të bashkësisë lokale, kuptohet me një kompensim të duhur

¹⁸ Për më tepër shih në: Shasivari Dr. Jeton, E drejta kushtetuese, botimi i dytë, Shkup, 2020, fq. 319-320 dhe Поповски, Др., Владо, “Локалната самоуправа во РМ”, Годишник на Правниот факултет-Скопје во чест на Тодорка Оровчанец, Том 42, 2006, стр. 361-376.

ligjor dhe legjitim në planin financiar dhe moral për bartësin e këtij funksioni. Në këtë drejtim, pa ndonjë gabim të madh, mund të konstatohet se, motivacioni për t'u bërë prefekt është i zhvendosur kah benefitet dhe favoret personale, kah benefitet e partisë politike amë të prefektit si dhe kah benefitet e strukturës së tij biznesore. Në suaza të këtij trendi, dita-ditës po bëhet i dukshëm orientimi i prefektit për të promovuar trupet apo ekipet e tija jo formale dhe jashtë institucionale, më çka ky funksion publik po merr përmasa drastike të një menaxhmenti privat apo të një menaxhmenti që i përzier punët publike me ato private, gjë që kuptohet se, është në kundërshtim me esencën dhe frymën e qeverisjes lokale dhe pozicionin e prefektit në strukturën e saj¹⁹. Në këtë drejtim, siç potencon prof. Shasivari thënë në përgjithësi, pozicioni i prefektit, ashtu siç është sot, do të ndikojë dukshëm në drejtim të asaj që qeverisja lokale në RMV edhe një kohë të gjatë të mos realizohet si një parim demokratik dhe si një e drejtë reale e qytetarëve dhe bashkësive lokale, për arsye se, tani për tani, prefekti është treguar më tepër si një faktor i oligarkizimit të qeverisjes lokale se sa si një faktor i demokratizimit të tij. Me një tendencë të tillë, që është e pranishme në shumë komuna, edhe më tej, do të mbetet retorika boshe si dhe keqpërdorimi i interesave lokale nga ana e qarqeve të ndryshme klanore, oligarkike, partiake, biznesore, etj²⁰.

1.4 Qeverisja lokale në RMV pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit më 13.08.2001 si dhe pas miratimit të Amendamenteve kushtetuese në bazë të saj, me anë të pakos ligjore të miratuar në vitin 2002 dhe vitin 2004, qeverisja lokale në RMV përjetoi ndryshime të rëndësishme në pjesën rreth kompetencave dhe financimit të tij. Por, me këto ligje nuk u prek tipi dhe shkalla e qeverisjes lokale në RMV. Reforma e përfshirë me anë të këtyre ligjeve qenësisht i zmadhoi kompetencat e qeverisjes lokale në RMV dhe e përforcoi sistemin e financimit të tij. Lista e kompetencave përfshin 12-të lëmi në të cilat parashihen funksione dhe detyra të shumënumërta dhe komplekse të qeverisjes lokale. Regjistri i kompetencave përnjëherë u bë aq i madh dhe aq i zgjeruar sa që, vështruar krahasimtarisht, mund të thuhet se, qeverisja lokale e RMV-së, sipas

¹⁹ Për më tepër shih në: Shasivari Dr. Jeton, E drejta kushtetuese, botimi i dytë, Shkup, 2020, fq. 319-320.

²⁰ Ibid.

të gjitha gjasave, ka kompetenca më të mëdha në Evropë. Ky fakt, vetëvetiu, flet për konstruksionin e lëmit të kompetencave që është bërë më tepër në aspektin teknik se sa në atë praktik. Për këtë gjë flet, hapi i madh që është bërë rreth një pozicioni të tillë, përkatësisht nga pozicioni i një qeverisje lokale më të dobët dhe më inkompetente në Evropë. Është më se evident fakti se, modeli i kompetencave nuk është derivuar në një formë analitike nga gjendja faktike dhe nga aftësia reale e njësive të qeverisjes lokale dhe të institucioneve të saj në RMV. Dallimet ndërmjet njësive të qeverisjes lokale si dhe dallimet në aftësitë e tyre, burojnë si nga fakti i mungesës së pajisjeve dhe ndërtimit të tyre në aspektin e përgjithshëm institucional, teknik dhe kadrovik, poashtu edhe nga fakti i mungesës së trajnimit të duhur dhe të përvojës në ushtrimin e funksioneve profesionale dhe administrative në më tepër lëmi që iu lanë në dorë qeverisjes lokale. Në këtë drejtim, mjafton që ta kemi parasysh faktin se, ndërmjet njësive të qeverisjes lokale ekzistojnë dallime të tilla që nuk hasen në ndonjë vend tjetër, kur kihet parasysh fakti se në RMV regjistri i kompetencave është i njëjtë, si për Qytetin e Shkupit, ashtu edhe për komunat, të themi, të Zërnovcit, Manastirit, Bogovinjes apo Vraneshticës, ose thënë ndryshe, ai është i njëjtë edhe për komunat me përvojë të pasur administrative, institucionale, kadrovike dhe materiale-teknike, edhe për komunat popullsia lokale e të cilave nuk ka as edhe 10 deri 15 persona me arsimim sipëror dhe që s'kanë përvojën e duhur në qeverisjen me punët publike. Kur flitet për tipin dhe për shkallën e qeverisjes lokale në RMV, mund të thuhet se, ai edhe pas vitit 2005 ngeli ashtu çfarë ishte pra, edhe më tej kemi modelin e qeverisjes lokale monotipike dhe njëshkallëshe. Është e sigurtë se, me kalimin e kohës do të riaktualizohet çështja e qeverisjes lokale dyshkallëshe. Gjatë kësaj, do të bien poshtë të gjitha paragjykimet negative të ndërlidhur me segmentimin dhe separacionin etno-politik, sepse do të kuptohet se, këto procese nuk kanë lidhje me qeverisjen lokale dhe as që burojnë prej saj. Qeverisja lokale dyshkallëshe në RMV, mund të jetë një faktor pozitiv në jetën e popullsisë lokale por, vetëm me kusht nëse, ajo nuk i përsërit gabimet në të kaluarën lidhur me rrethet e sistemit të kaluar të QL-së²¹.

²¹ Për më tepër shih në: Shasivari Dr. Jeton, E drejta kushtetuese, botimi i dytë, Shkup, 2020, fq. 320-321 dhe Поповски, Др., Владо, "Локалната самоуправа во РМ", Годишник на Правниот факултет-Скопје во чест на Тодорка Оровчанец, Том 42, 2006, стр. 361-376.

1.5 Organizimi territorial i qeverisjes lokale në RMV

Me Ligjin për organizimin territorial të qeverisjes lokale në RMV të 11.08.2004 numri i komunave u zvogëlua nga 124 në 84 komuna. Në v. 2013, pas zgjedhjeve lokale të 24 marsit, komunat e Drugovës, Vraneshticës, Oslomejit dhe Zajasit, pushuan së ekzistuari dhe, iu bashkëngjitën Komunës së Kërçovës, kështu që, numri i komunave u zvogëlua nga 84 në 80 komuna, sa janë aktualisht në RMV. Qyteti i Shkupit është njësi e veçantë e qeverisjes lokale me sipërfaqe prej 571.46 km² dhe popullsi prej 506.926 banorëve, që në vete ka 10 komuna, edhe atë: Aerodromi, Kisella Voda, Karposhi, Buteli, Gazi Baba, Qendra, Saraji, Çairi, Shuto Orizarja dhe Gjorçe Petrovi. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në v. 2002, sipas numrit të banorëve, komunë më e madhe në RMV është ajo e Kumanovës me 105.484 banorë, ndërkaq, komunë më e vogël është ajo e Vevçanit me 2.433 banorë. Sipas sipërfaqes, komunë më e madhe në RMV është ajo e Prilepit me 1.194 km², ndërkaq më e vogël është ajo e Çairit me sipërfaqe prej 3.5 km²²².

Me këtë organizim aktual territorial të qeverisjes lokale në RMV, njësitë e qeverisjes lokale u bënë ende më të mëdha. Kështu që, madhësia mesatare e komunës u zmadhua nga 209 km² sa ishte në vitin 1996, në 306 km² sa është aktualisht, ndërkaq, aktualisht, numri mesatar i banorëve në komunë arriti në 25.000 përkundër 16.352 banorëve në periudhën 1996-2004. Në këtë mënyrë, RMV hyri në mesin e shteteve me komuna më të mëdha, në të cilat, më tepër gjasa ka që të zhvillohet qeverisja lokale e tipit përfaqësues se sa ajo e tipit të drejtpërdrejtë. Qeveria e asaj kohe, këtë zmadhim të komunës e arsyetonte me zmadhimin e kompetencave dhe financave të tyre si dhe, me qëllimin e saj që të krijojë komuna që do të jenë të afta të përballen me zhvillimin e bashkësisë lokale. Mirëpo, analizat konkrete të këtyre zgjidhjeve të Qeverisë, megjithatë e kundërshtojnë qëndrimin e saj, për arsye se rezultati përfundimtar flet për atë se, Qeverisë i doli nga kontrolli realizimi i këtij qëllimi dhe, në vend të tij, dolën në pah momente të tjera, edhe atë: interesat partiake, efektet lobuese dhe stereotipet krahinore të një pjesë e pushtetarëve të atëhershëm qendror. Mbi këto baza, edhe u krijua ndarja territoriale, që nuk flet për një politikë konsistente të pushtetit ekzekutiv. Thënë më konkretisht, me këtë Ligj: u ruajt komuna e Zërnovcit me tri fshatra të cilët aspak nuk

²² Për më tepër shih në: Shasivari Dr. Jeton, E drejta kushtetuese, botimi i dytë, Shkup, 2020, fq. 321.

formojnë ndonjë tërësi lokale; u ruajt komuna e pa aftë dhe dobët e zhvilluar e Zelenikovës; pa sensin e duhur, u bashkuan komunat e Beliçicës dhe Mesheishtës, të cilat përbëjnë një tërësi lokale krejtësisht të ndryshme dhe asnjëherë nuk kanë gravituar njëra me tjetrën; Komunës së Tetovës dhe komunës së Gostivarit iu bashkëngjitën ish-komunat e Xhepçishtit dhe Banjicës së Poshtme, të cilat në ndarjen paraprake, dëshmuuan se me sukses mund të përballen me zhvillimin e bashkësisë lokale. Zmadhimi i komunave për arsye të zmadhimit të kompetencave të tyre, është e arsyeshme nëse ajo realizohet në suaza të komunave të të njëjtit lloj. Se ky nuk ka qenë qëllimi i Qeverisë, flasin faktet në vijim: në vend që ish-komunat e Banjicës, Sërbinovës dhe Vërtokut, të bashkohen në një komunë të madhe unike e rurale me seli në Banjicë, të gjitha këto bashkohen me Komunën e Gostivarit. Në vend që komunat e Bisticës dhe Baçit të bashkohen në një tërësi lokale, ato bashkohen me Komunën e Manastirit. Në komunën e Bisticës jetonin mbi 20% shqiptarë, kurse Komuna aktuale e Manastirit ka vetëm 4-5% shqiptarë. Komuna e Xhepçishtit që ishte një komunë e madhe edhe sipas sipërfaqes edhe sipas numrit të banorëve dhe kapaciteteve ekonomike, në vend që të mbetej edhe më tutje si komunë e veçantë, ajo iu bashkua Komunës së Tetovës, etj²³.

Në këtë drejtim, nga 10-të komunat e Tetovës, katër prej tyre: Kamjani, Shipkovicë, Vratnica dhe Xhepçishti pushuan së ekzistuari. Sipas çdo kriteri, Komuna e Vratnicës për shkak të konfiguracionit natyror që ka, duhej t'i bashkëngjitej Komunës së Tearcës, sepse jo vetëm që kufizohet me të, por edhe mbarë infrastrukturën rrugore, qarkullimin dhe lidhjen me qytetin e Tetovës e ka vetëm përmes kësaj komune. Komuna e Vratnicës dhe e Jegunovcës nuk kanë kurrfarë lidhje tokësore mes vete. Nga këto shkaqe natyrore, tani të gjithë banorët e ish-Komunës së Vratnicës, fshatrat: Bellovisht, Jazhincë, Orashë, Rogaçevë, Staro Sellë dhe Vratnicë, për të kryer nevojat e veta, në komunën e tanishme të Jegunovcës, detyrohen të kalojnë nëpër Komunën e Tearcës. Komuna e Vratnicës nuk iu bashkëngjit Komunës së Tearcës për shkak se përbërja e popullsisë në këtë komunë është 88% shqiptarë. Pra, në këtë rast, përveç se u shkel çdo kriter për formimin e komunave, iu shkaktua edhe dëm i madh vetë

²³ Për më tepër shih në: Shasivari Dr. Jeton, E drejta kushtetuese, botimi i dytë, Shkup, 2020, fq. 321-323 Поповски, Др., Владо, "Локалната самоуправа во РМ", Годишник на Правниот факултет-Скопје во чест на Тодорка Оровчанец, Том 42, 2006, стр. 361-376.

banorëve. Qëllimi i vetëm ishte që popullata maqedonase e Komunës së Vratnicës të mos udhëhiqet nga shqiptarët, por nga maqedonasit²⁴.

Nga ana tjetër, kjo reformë e organizimit territorial të qeverisjes lokale të v. 2004 duket se është nxitur nga synimi i dyfishtë, edhe atë:


I pari, nevoja për të thjeshtuar organizimin e komunave duke zhveshur ato që janë shumë të vogla dhe nuk kanë rezultuar të zbatueshme; mirëpo, përkundër reformës, struktura e komunave aktualisht mbetet e larmishme, me shumë komuna të vogla: 16 komuna kanë një popullsi më të vogël se 5.000 dhe 32 komuna popullsi më të vogël se 10.000. Vetëm 22 komuna kanë një popullsi më të madhe se 30.000 banorë; dhe,

I dyti, synimi për të rregulluar proporcionet midis komunitetit maqedonas dhe shqiptar në disa komuna (si për shembull, në komunën e Kërçovës, ku shqiptarët shkuan nga 20% e popullsisë në 50% kur kjo komunë u bashkua me komunat fqinje). Në këtë drejtim, vlen të permendet edhe fakti se, procesi i organizimit territorial të v. 2004 nuk ka qenë objekt i konsultimeve paraprake me autoritetet lokale, me çrast një seri referendumesh (30 referendume lokale të suksesshme dhe një referendum nacional i pasuksesshëm) u mbajtën për të kundërshtuar këtë ligj, mirëpo, ky proces përfundimisht u pranua ashtu siç parashikohej me këtë ligj në fuqi²⁵.

²⁴ Për më tepër shih në: Nesimi, Mahi, Shqiptarët e Maqedonisë dhe ardhmëria e shtetit, Focus Print-Shkup, Tetovë, 2019, fq. 246-247.

²⁵ Për më tepër shih në: Davkova-Siljanovska, Dr., Gordana, "Legal and Institutional Framework of Local Self-Government in the Republic of Macedonia", Lex Localis-Journal of Local Self-Government, Vol. 7, No. 2, pp 107-127, April 2009.

Paraqitja grafike e organizimit territorial të qeverisjes lokale në RMV²⁶



Komunat në RMV: 1. Aerodrom; 2. Haračinë; 3. Berovë; 4. Manastir; 5. Bogdanci; 6. Bogovinë; 7. Bosilovë; 8. Brvenicë; 9. Butel; 10. Vallandovë; 11. Vasilevë; 12. Vevčan; 13. Veles; 14. Vinicë; 15. Vrapçisht; 16. Gazi Babë; 17. Gjevgjeli; 18. Gjorçe Petrov; 19. Gostivar; 20. Dibër; 21. Debarcë; 22. Dellçevë; 23. Demir Kapi; 24. Demir Hisar; 25. Dojran; 26. Dollnen; 27. Zhelinë; 28. Zelenikovë; 29. Zërnovcë; 30. Ilinden; 31. Jegunovcë; 32. Kavadarcë; 33. Karbincë; 34. Karposh; 35. Kisella Vodë; 36. Kërçovë; 37. Konçe; 38. Koçanë; 39. Kratovë; 40. Kriva Pallankë; 41. Krivogashtani; 42. Krushevë; 43. Kumanovë; 44. Likovë; 45. Llozovë; 46. Mavrovë dhe Rostushë; 47. Makedonska Kamenicë; 48. Makedonski Brod; 49. Mogillë; 50. Negotinë; 51. Novaci; 52. Novo Sellë; 53. Ohër; 54. Petrovec; 55. Pehçevë; 56. Pllasnicë; 57. Prilep; 58. Probishtip; 59. Radovich; 60. Rankovcë; 61. Resnjë; 62. Rosoman; 63. Saraj; 64. Sveti Nikollë; 65. Shkup; 66. Sopishtë; 67. Staro Nagoriçane; 68. Strugë; 69. Strumicë; 70. Studenicë; 71. Tearcë; 72. Tetovë; 73. Qendër Zhupa; 74. Çair; 75. Çashkë; 76. Çeshinovë; 77. Çucer Sandevë; 78. Shtip; 79. Qendër dhe 80. Shuto Orizarë.

1.6 Procesi i decentralizimit të kompetencave të qeverisjes lokale në RMV

Decentralizimi është qendra e jetës politike dhe administrative të Maqedonisë në vitet e fundit. Fillimisht, pas pavarësisë së vendit në vitin 1991, autoritetet miratuan një strategji të centralizimit të pushtetit në mënyrë që të forcojnë kontrollin e tyre mbi të gjithë territorin. Kjo

²⁶ Ministria e qeverisjes lokale në RMV: Komunat në RMV, e arritshme në: <<http://mls.gov.mk/sq/rajonet-dhe-komunat-n%C3%AB-maqedoni/komunat>>.

strategji u përmbys pas konfliktit të vitit 2001 dhe Marrëveshjen e Ohrit. Për të siguruar një shpërndarje më të mirë të pushtetit mes komuniteteve të ndryshme lokale që jetojnë në Maqedoni, Marrëveshja e Ohrit bëri thirrje për një reformë të decentralizimit të pushtetit. Kjo reformë, i mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe aktorët kryesore ndërkombëtare në Maqedoni, ka rezultuar në ndryshime të mëdha legislative në vitin 2004. Territori i Maqedonisë është e ndarë tani në 84 komuna (plus Qyteti i Shkupit, i përbërë nga 10 komuna). Këto komuna kanë më shumë pushtet se më parë në marrjen e vendimeve dhe buxheteve menaxhimit. Komunat kanë një fuqi vendim-marrjes lidhur ekonomik lokal, mbrojtjen mjedisore të zhvillimit dhe natyrën, kulturën, planifikimin urban, sport, mirëqenien sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve, dhe se arsimit. Realizimi praktik i këtij procesit të decentralizimit është ende në vazhdim. Transferimi i aftësive të takohet me disa probleme për shkak të kompleksitetit të procesit, por edhe me gjendjen e tranzicionit politik dhe ekonomik përballet me Maqedoninë. Në krye të secilës komunë janë një kryetar dhe këshilltarë të zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë universale. Komunat financohen nga burimet e tyre, nga tatimi mbi të ardhurat, dhe nga grantet nga buxheti kombëtar. Për të siguruar një shpërndarje më të mirë të pushtetit mes bashkësive etnike, disa vendimmarrje në nivel komunal të kalojë përmes zhvillim "Badinterit", të quajtur pas francez Badinter ish-ministrit, Robert. Ky parim nënkupton që votimi në fjalë duhet të mbajnë një shumicë votash të dy grupeve: atë të të gjithë këshilltarëve, në mesin e atyre që i këshilltarëve që përfaqësojnë komunitetet e pakicave etnike në komunë. Dispozitat e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit 13 gusht 2001, Marrëveshja Kornizë e Ohrit ka imponuar reforma të rëndësishme për të më mirë të përfaqësojë minoritetet dhe duke siguruar një kushtetutë të re. Sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje, 1991 Kushtetuta është ndryshuar për të fshirë referencën që sllavët maqedonas janë populli i vetëm themelues të vendit. Shoqëria shihet tashmë si i përbërë nga qytetarë të grupeve të ndryshme etnike. Marrëveshja përcakton një sistem të "shumicës së dyfishtë" në Parlament, i cili siguron që, për t'u miratuar, një tekst duhet të plotësojnë së paku gjysmën e votave të një apo formacioneve të ndryshme që përfaqësojnë pakicat etnike. Përdorimi i shqipes është i autorizuar për dokumentet zyrtare dhe si gjuhë pune në seancat plenare dhe komisioneve parlamentare, si dhe në gjykatë. Të gjitha ligjet janë të shkruara në dy gjuhë, maqedonase dhe

shqiptare. Megjithatë, vetëm maqedonas mund të përdoret nga qeveria maqedonase (përveç në zona të caktuara shqiptare). Shqiptari është gjuha e dytë zyrtare në zonat ku shqiptarët përbëjnë mbi 20 për qind të popullsisë. Shteti merr përsipër të financojë, përveç arsimit fillor dhe të mesëm, arsimin e lartë (Universiteti) në gjuhën shqipe në zonat ku shqiptarët përbëjnë së paku 20% të popullsisë²⁷.

²⁷ Për më tepër shih në: Decentralizimi në Maqedoni: <http://bn-mk.org/sq/content/decentralizimi-n%C3%AB-maqedoni.html>.

KAPITULLI I DYTË
KOMPETENCAT KOMUNALE, ORGANET E QEVERISJES LOKALE DHE DEMOKRACIA LOKALE
NË RMV

2.1 Kompetencat komunale të qeverisjes lokale në RMV

Lidhur me kompetencat komunale, duhet theksuar se, Ligji aktual për qeverisjen lokale bën një ndryshim cilësor në krahasim me Ligjin e mëparshëm të v. 1995, duke rritur numrin e kompetencave komunale, mirëpo megjithatë duke mos i barazuar ato me kompetencat e qeverisjeve lokale më të zhvilluara në botë. Mirepo, në kompetencat komunale nuk bëjnë pjesë edhe çështjet nga lëmi i strehimit, politikave banesore si dhe kompetencat thelbësore nga lëmi i kujdesit primar shëndetësor që përfshin ambulancat, ordinancat, etj., që kanë një numër relativisht të vogël të punonjësve.

Fillimisht, sipas ligjit aktual, me kompetencë të komunës nënkuptohet, tërësia e punëve me interes publik e me rëndësi lokale që në përputhje me ligjin, komuna ka të drejtë t'i kryejë në territorin e vet dhe mban përgjegjësi për kryerjen e tyre²⁸.

Gjatë përcaktimit të kompetencës së përgjithshme të komunave, ligjvënësi udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit, me çrast, komunat, në suaza të ligjit, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, kanë të drejtë në territorin e vet t'i kryejnë punët e interesit publik me rëndësi lokale, që nuk janë të përjashtuara nga kompetencat e tyre ose nuk janë në kompetencë të organeve të pushtetit shtetëror²⁹. Në këtë drejtim, në frymën e Kartës Evropiane për qeverisje lokale, ligji në fuqi në dispozitën e nenit 21 të tij, përcakton tri parime të rëndësishme lidhur me kompetencat komunale, edhe atë: i pari, komunat në mënyrë të pavarur, në suaza të ligjit, i rregullojnë dhe i kryejnë punët e interesit publik me rëndësi lokale, të përcaktuara me këtë ose ligj tjetër dhe janë përgjegjëse për kryerjen e tyre; i dyti, me ligjin me të cilin rregullohen kompetencat e tjera të komunave caktohen edhe burimet financiare për kryerjen e atyre kompetencave; dhe, i treti, kompetencat komunale parimisht janë të plota dhe unike dhe, nuk guxojnë të merren ose të kufizohen, përveçse në raste të përcaktuara me ligj³⁰.

Në këtë drejtim, bëhet dallimi i dy llojeve të kompetencave komunale, edhe atë: kompetenca të përcaktuara me ligj dhe kompetenca të deleguara.

²⁸ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 2, paragrafi 1, pika 6.

²⁹ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 20.

³⁰ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 21.

Lidhur me llojin e parë, pra kompetenca të përcaktuara me ligj, ligji në fuqi në dispozitën e nenit 22 të tij, përcakton listën e kompetencave komunale. Kështu, komunat janë kompetente për kryerjen e punëve në 12-të lëmi vijuese:

1. Planifikimi urbanistik (urban dhe rural), dhënia e lejes për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale të përcaktuara me ligj, rregullimi i hapësirës dhe rregullimi i tokës ndërtimore.

2. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës-masa për mbrojtje dhe pengimin nga ndotja e ujit, ajrit, tokës, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurmimi dhe rrezatimi jonizues.

3. Zhvillimi ekonomik lokal-planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal; përcaktimi i përparësive zhvillimore dhe strukturale, udhëheqja me politikën ekonomike; përkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të iniciativave në nivel lokal dhe në atë kontekst pjesëmarrja në vendosjen dhe zhvillimin e rrjetit lokal të institucioneve dhe agjensive dhe promovimi i partneritetit;

4. Veprimtaritë komunale-furnizimi me ujë për pije; përcjellja e ujit teknologjik; përcjellja dhe pastrimi i ujërave të ndotura; ndriçimi publik; dërgimi dhe trajtimi i ujërave atmosferik; mirëmbajtja e higjienës publike; grumbullimi, transportimi dhe procedimi me mbeturinat e ngurta komunale; rregullimi dhe organizimi i trafikut publik lokal të udhëtarëve; furnizimi me gaz natyror dhe energji ngrohëse; mirëmbajtja e varreve, varrezave, krematoriumeve dhe dhënia e shërbimeve mortërore; ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale, rrugëve dhe objekteve të tjera të infrastrukturës; rregullimi i regjimit të komunikacionit; ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimeve rrugore të komunikacionit, ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirës publike të parkimit; mënjanimi i automjeteve të parkuara gabimisht; mënjanimi i automjeteve të dëmtuara nga sipërfaqet publike; ndërtimi dhe mirëmbajtja e tregjeve; pastrimi i oxhaqeve; mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve, gjelbërimit, park-pyjeve dhe sipërfaqeve rekreative; rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i shtratit të lumenjëve në pjesët e urbanizuara; përcaktimi i emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera të infrastrukturës.

5. Kultura-përkrahja institucionale dhe financiare të enteve dhe projekteve kulturore; kultivimi i folklorit, zakoneve, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore; organizimi i manifestimeve kulturore; nxitja e formave të llojllojshme specifike të krijimtarisë.

6. Sporti dhe rekreacioni-zhvillimi i sportit masiv dhe i aktiviteteve rekreative; organizimi i shfaqjeve dhe manifestimeve sportive; mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve për sport; përkrahja lidhjeve sportive;

7. Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve-çerdhe për fëmijë dhe shtëpi të pleqëve (pronësi, financim, investime dhe mirëmbajtje); realizimi i përkujdesjes sociale për persona invalidë; fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore; fëmijëve me probleme edukativo-sociale; fëmijëve me nevoja të veçanta; fëmijëve nga familjet njëprindërore; fëmijëve në rrugë; personave të ekspozuar rrezikut social; personave të prekur nga keqpërdorimi i drogës dhe alkoolit; ngritja e vetëdijes së popullatës; strehimi i personave të rrezikuar social; realizimi i së drejtës dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore. Kryerja e këtyre kompetencave është në pajtueshmëri me Programin Nacional për zhvillim të mbrojtjes sociale;

8. Arsimi-themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme, në bashkëpunim me pushtetin qendror, në pajtueshmëri me ligjin, organizimi i transportit dhe i ushqimit të nxënësve dhe vendosjen e tyre në konvikte nxënësish;

9. Mbrojtja shëndetësore—të drejtuarit me rrjetin e organizatave publike shëndetësore dhe me objektet nga mbrojtja shëndetësore primare të cilët duhet ta përfshijnë përfaqësimin e qeverisjes lokale në të gjitha këshillat të të gjitha organizatave në pronësi publike, edukata shëndetësore; përparimi i shëndetit; aktivitete preventive; mbrojtja e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtja gjatë punës; mbikëqyrja shëndetësore mbi mjedisin jetësor; mbikëqyrja mbi sëmundjet ngjitëse; ndihmë pacientëve me nevoja speciale dhe lëmenjë të tjerë që do të përcaktohen me ligj;

10. Zbatimi i përgatitjeve dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës, nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera dhe nga pasojat e shkaktuara nga to.

11. Mbrojtja kundër zjarrit që kryejnë njësitë territoriale kundër zjarrit;

12. Mbikëqyrja mbi kryerjen e punëve nga kompetenca e saj dhe

13. Punë të tjera të përcaktuara me ligj³¹.

³¹ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 22.

Lidhur me llojin e dytë, pra kompetenca të deleguara, ligji në fuqi në dispozitën e nenit 23 të tij, përcakton se, organet e administratës shtetërore mund t'ia delegojnë kryerjen e punëve të caktuara nga kompetencat e veta prefektit (kryetarit të komunës), në përputhje me ligjin, me çrast, barten edhe mjetet e parapara në buxhetin e Republikës për kryerjen e atyre punëve. Mënyra e kryerjes së këtyre punëve mund t'iu adaptohet kushteve lokale, me respektimin e standardeve të përcaktuara me ligj. Organi i administratës shtetërore në mënyrë subsidiare është përgjegjës për kryerjen e punëve të deleguara³².

Poashtu, duhet theksuar se, gjatë kryerjes së punëve që janë në kompetencë të komunave, komunat mund të themelojnë edhe shërbime (veprimtari) publike në përputhje me ligjin. Në këtë drejtim, sipas ligjit në fuqi, për kryerjen e kompetencave të veta komunat mund të themelojnë veprimtari publike në përputhje me ligjin. Komunat mund t'ua delegojnë kryerjen e punëve të caktuara me interes publik dhe me rëndësi lokale personave të tjerë juridik ose fizik, në bazë të kontratës për kryerjen e punëve me interes publik, në përputhje me ligjin. Komuna është subsidiarisht përgjegjëse për kryerjen e punëve të interesit publik³³.

2.2 Organet e qeverisjes lokale në RMV

Sipas ligjit në fuqi, organe të komunës janë: Këshilli dhe Prefekti (Kryetari i Komunës)³⁴.

2.2.1 Këshilli i Komunës

Këshilli i Komunës paraqet organin kolegjal përfaqësues të qytetarëve, të cilin e përbëjnë përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Anëtarët e këshillit zgjedhen me mandat katërvjeçar, i përfaqësojnë qytetarët dhe në këshill vendosin sipas bindjeve të tyre. Anëtari i këshillit nuk mund të revokohet. Këshilli përbëhet prej 9 deri 33 anëtarëve varësisht nga numri i banorëve në komunë, edhe atë:

³² Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 23.

³³ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 24.

³⁴ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 31.

Tabela 1: Numri i anëtarëve të Këshillit të Komunës sipas numrit të banorëve në komunë³⁵

Numri i banorëve	Numri i anëtarëve të Këshillit
deri 5.000	9
prej 5.001 deri 10.000	11
prej 10.001 deri 20.000	15
prej 20.001 deri 40.000	19
prej 40.001 deri 60.000	23
prej 60.001 deri 80.000	27
prej 80.001 deri 100.000	31
mbi 100.000	33

Sipas ligjit në fuqi, këshilli i ka kompetencat vijuese:

1. Sjell statutin e komunës dhe dispozita të tjera;
2. Sjell buxhetin dhe llogarinë vjetore të komunës;
3. Përcakton shumën e burimeve personale të të ardhurave të financimt të komunës, në suaza të përcaktuara me ligj;
4. Themelon veprimtari publike në suaza të kompetencave të komunës dhe bënë mbikëqyrjen mbi punën e tyre;
5. Emëron anëtarë të këshillave drejtues të veprimtarive publike të cilat i themelon;
6. Sjell programe për punë dhe plane financiare për financim të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna;
7. I miraton raportet për realizimin e buxhetit dhe llogarinë vjetore të komunës;
8. Vendos për dhënien e lejeve për kryerje të veprimtarisë të interesit publik me rëndësi lokale në përputhje me ligjin;
9. I miraton raportet për punën e veprimtarive publike që i ka themeluar komuna;
10. Vendos për mënyrën e disponimit me pronën e komunës;

³⁵ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 34.

11. Vendos mbi mënyrën e kryerjes së kontrollit financiar të buxhetit të komunës në përputhje me ligjin;

12. Zgjedh personin që udhëheq me njësinë rajonale të Ministrisë për punë të brendshme në komunë, në përputhje me ligjin;

13. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor për sigurinë publike në territorin e komunës, të cilin e dorëzon deri te Ministri i punëve të brendshme dhe Avokati i Popullit;

14. Mund t'i jep rekomandime personit udhëheqës të njësisë rajonale të Ministrisë për punë të brendshme nga fusha e sigurisë publike dhe sigurisë në komunikacion dhe

15. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj³⁶.

Seancën e parë konstituive të këshillit të ri të zgjedhur e thërret kryetari i këshillit nga përbërja paraprake më së voni në afat prej 20 ditësh nga dita e përfundimit të zgjedhjeve. Nëse këshilli nuk thirret brenda këtij afati, anëtarët e këshillit tubohen vet dhe nën kryesimin e anëtarit më të vjetër të këshillit e konstituojnë këshillin në afat prej 10 ditësh pas skadimit të afatit paraprak. Nëse seanca nuk mbahet edhe brenda këtij afati plotësues, do të shpallen zgjedhje të reja për anëtarë të këshillit, në mënyrë të përcaktuar me ligj. Seancat e këshillit thirren sipas nevojës por, më së paku njëherë në tre muaj. Seancat i thërret kryetari i këshillit me iniciativë të vet, me kërkesë të prefektit ose me kërkesë të më së paku ¼ të anëtarëve të këshillit më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së saj. Nëse brenda këtij afati, kryetari i këshillit nuk e thërret mbledhjen e këshillit, anëtarët e këshillit tubohen vet dhe zgjedhin kryetar për atë seancë. Dita, ora dhe vendi i mbajtjes së seancave të këshillit si dhe propozimi i rendit të ditës sipas të cilit do të punohet, detyrimisht shpallen më së voni shtatë ditë para ditës së mbajtjes së seancës, në mënyrë të përcaktuar me statutin. Këshilli mund të punojë nëse në seancë merr pjesë shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Këshilli vendos me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm, nëse me ligj dhe me statutin nuk është përcaktuar ndryshe. Dispozitat që kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve dhe shkrimit në të cilën flasin më pak se 20% nga qytetarët në komunë, përcaktimi dhe përdorimi i stemës dhe flamurit të komunës miratohen me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të këshillit, me çrast patjetër duhet të ketë shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të këshillit

³⁶ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 36.

të cilët i takojnë bashkësive të cilët nuk janë shumicë e popullatës së komunës. Në seancat e këshillit, parimisht, votohet në mënyrë publike. Për çdo mbledhje të këshillit mbahet procesverbal. Këshilli punon në seanca. Seancat e këshillit janë publike. Për përjashtimin e prezencës së publikut në seancë vendoset nëse për të ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të përcaktuara me statut, me dy të tretën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Në debatin për buxhetin e komunës, llogarinë përfundimtare të buxhetit dhe planet urbanistike, prania e publikut nuk mund të përjashtohet³⁷.

Kryetari i këshillit zgjedhet nga përbërja e anëtarëve të këshillit, me mandat katërvjeçar. Për kryetar të këshillit zgjedhet kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët për kryetar nuk ka fituar numër të mjaftueshëm të votave, kalohet në rrethin e dytë të votimeve për dy kandidatët që në rrethin e parë kanë fituar më shumë vota. Për kryetar është zgjedhur anëtari i këshillit i cili në rrethin e dytë të votimit ka fituar më shumë vota. Deri në zgjedhjen e kryetarit, seancat e këshillit i thërret dhe me ato udhëheq anëtari më i vjetër i këshillit.

Kryetari i këshillit i ka këto obligime:

1. I thërret dhe udhëheq me seancat e këshillit;
2. Kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit dhe
3. I nënshkruan dispozitat që i ka sjellur këshilli dhe në afat prej tre ditësh nga dita e sjelljes ia dorëzon prefektit për publikim³⁸.

Lidhur me të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të këshillit, anëtarët e këshillit kanë të drejtë dhe obligim të jenë prezent dhe të marrin pjesë në punën e këshillit dhe në komisionet e tij të përhershme dhe të përkohëshme. Anëtarët kanë të drejtë në seancat e këshillit të japin iniciativa dhe propozime dhe t'i parashtojnë pyetje prefektit. Anëtari i këshillit nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shfaqur ose për votim në këshill. Punëdhënësi është i detyruar ta lirojë nga puna profesionale anëtarin e këshillit për të marrë pjesë në seancat e këshillit ose komisioneve ku ai është anëtar. Anëtarët e këshillit kanë edhe të

³⁷ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, nenet 37-42.

³⁸ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, nenet 47-48.

drejta dhe obligime të tjera të përcaktuara me statutin dhe dispozitat tjera në përputhje me këtë ligj³⁹.

Lidhur me ndërprerjen e mandatit të anëtarit të këshillit, ligji në fuqi përcakton se, anëtarit të këshillit i pushon mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur:

-nëse jep dorëheqje;

-në rast vdekjeje;

-nëse me vendim të plotfuqishëm, për vepër penale, është dënuar me burgim në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj.

-nëse paraqitet rast i papërputhshmërisë me funksionin anëtarë i këshillit në përputhje me Ligjin për zgjedhje lokale;

-nëse me vendim të plotfuqishëm i merret e drejta e zotësisë së veprimit; dhe

-nëse pushon të jetë banor i komunës. Anëtarit të këshillit mund t'i merret mandati nëse pa arsye mungon nga seancat tri herë radhazi⁴⁰.

Ligji në fuqi rregullon edhe çështjen e konfliktit të intereseve të anëtarëve të këshillit. Kështu, anëtari i këshillit nuk mund të marrë pjesë në procesin e sjelljes së vendimeve për çështje në të cilat ai ose bashkëshorti i tij, fëmija ose kushërinjtë deri në brezin e dytë anësor kanë interes personal financiar ose interes tjetër. Anëtari i këshillit është i obliguar ta informojë këshillin për çështjet për të cilat ai ka interes financiar ose interes tjetër personal. Anëtari i këshillit nuk mund të jetë i punësuar në administratën komunale të komunës ku ai është i zgjedhur. Nga dita e punësimit, do të konsiderohet se anëtari i këshillit ka dhënë dorëheqje. Anëtari i këshillit i punësuar në veprimtaritë publike që i ka themeluar komuna, nuk mund të marrë pjesë në marrjen e vendimeve për çështje që kanë të bëjnë me veprimtarinë publike në të cilën është i punësuar⁴¹.

Pokështu, ligji në fuqi rregullon edhe çështjen e shpërndarjes së këshillit, me vetiniciativë dhe sipas kushteve ligjore. Kështu, këshilli i komunës shpërndahet nëse për atë deklarohet shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të tij. Këshilli shpërndahet nëse:

³⁹ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 43.

⁴⁰ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 46.

⁴¹ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 44.

1. Sërish e miraton dispozitën që paraprakisht është anuluar ose ndërprerë me vendim të Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

2. Sjell vendim me të cilin rrezikohet sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

3. Nuk takohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj; dhe,

4. Nuk e miraton buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit deri në 31 mars të vitit vijues. Ministria kompetente për kryerjen e punëve nga lëmi i qeverisjes lokale, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimi të njoftimit, Qeverisë së Republikës do t'i paraqesë propozim për shpërndarjen e këshillit. Qeveria e Republikës, në afat prej një muaji nga dita e pranimi të këtij propozimi, do të sjell vendim për shpërndarjen e këshillit sipas fuqisë ligjore, të cilin e shpall në: "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Për periudhën e mbetur zgjedhore do të shpallen zgjedhje të reja për këshill në përputhje me Ligjin për zgjedhje lokale. Zgjedhjet nuk do të mbahen nëse deri te periudha e re zgjedhore ka më pak se gjashtë muaj.

Deri te zgjedhja e këshillit të ri, punët e këshillit i kryen prefekti i komunës. Gjatë kryerjes së punëve, prefekti nuk mund:

-të vendos për çështje që kanë të bëjnë me disponimin e pronës së komunës;

-të vendos për çështje në të cilat ai ose bashkëshorti i tij, fëmijët ose kushërinjtë deri në brezin e dytë të linjës anësore kanë interes financiar ose interes tjetër personal; dhe,

-të nxjerr dispozita lidhur me kompetencat e këshillit⁴².

2.2.2 Kryetari i Komunës-Prefekti

Kryetari i Komunës ose Prefekti paraqet organin individual ekzekutiv të komunës me kompetenca të gjera dhe të rëndësishme, ku pozita i tij buron nga mënyra e drejtpërdrejtë e zgjedhjes së tij, sepse ai/ajo zgjedhet në çdo katër vite në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdejtja dhe të lira me votim të fshehtë, me çrast ligji në fuqi, përcakton se, prefekti i ka kompetencat vijuese:

1. E përfaqëson komunën;

2. E kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të këshillit;

⁴² Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, nenet 74-77.

3. I shpall dispozitat e këshillit në Gazetën zyrtare të komunës;
4. E siguron zbatimin e vendimeve të këshillit;
5. E siguron kryerjen e punëve të cilat me ligj i janë deleguar komunës;
6. Inicion dhe propozon sjelljen e dispozitave nga kompetencat e këshillit;
7. E propozon buxhetin vjetor të komunës dhe llogarinë vjetore të buxhetit të komunës;
8. E realizon buxhetin e komunës;
9. Zgjedh drejtorë të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna, në bazë të konkursit publik;
10. Rregullisht e njofton këshillin për kryerjen e kompetencave të veta në përputhje me statutin;
11. Vendos në çështje administrave për të drejtat, obligimet dhe intereset e personave juridik dhe fizik, në përputhje me ligjin;
12. Sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale;
13. Udhëheq me administratën komunale;
14. Vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësi të punësuarve në administratën e komunës, nëse ndryshe nuk është e përcaktuar me ligj;
15. Siguron shfrytëzim të drejtë dhe ligjor, mirëmbajtje dhe mbrojtje të pronës së komunës, në përputhje me ligjin dhe statutin; dhe
16. Kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin. Prefekti mund të autorizojë nëpunës udhëheqës së komunës që të udhëheq procedurën dhe të vendos për çështje administrative si dhe të nënshkruajë akte⁴³.

Prefekti i sapo zgjedhur e pranon detyrën nga prefekti i mëparshëm në afat prej shtatë ditësh prej ditës së zgjedhjes. Prefekti në mënyrë profesionale e kryen funksionin e vet. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit, prefekti nuk mund të kryejë detyra të tjera profesionale. Prefekti nuk mund të merret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shfaqur në këshill. Prefekti cakton se cili nga anëtarët e këshillit do ta zëvendësojë në rast pengese ose mungese, në përputhje me procedurën e përcaktuar me statut. Anëtarit të këshillit i pushon funksioni i anëtarit të këshillit gjatë kohës kur e zëvendëson prefektin. Kryetari i këshillit nuk

⁴³ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 50.

mund ta zëvendësojë prefektin. Rroga dhe kompensimet e prefektit, si dhe kompensimi për anëtarin e këshillit i cili e zëvendëson prefektin, rregullohen me ligj⁴⁴.

Pokështu, ligji në fuqi rregullon edhe çështjen e konfliktit të intereseve të prefektit. Kështu, prefekti nuk mund të emërohet për anëtar i organeve mbikëqyrëse, administrative, kontrolluese të shoqërive tregtare dhe veprimtarive publike. Prefekti nuk mund të marrë pjesë në procesin e sjelljes së vendimeve për çështje në të cilat ai ose bashkëshorti, fëmijët ose kushërinjtë deri në brezin e dytë anësor kanë interes personal financiar ose interes tjetër. Prefekti është i obliguar që ta njoftojë këshillin për këtë interes, me çrast, vendimin e sjell njëri nga anëtarët e këshillit i zgjedhur në të njëjtën mënyrë siç zgjedhet kryetari i këshillit⁴⁵.

Ligji në fuqi rregullon edhe çështjen e kontrollit të ligjshmërisë së dispozitave para shpalljes së tyre. Kështu, nëse prefekti vlerëson se dispozita e këshillit nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet është i obliguar që në afat prej shtatë ditësh nga dita e dorëzimit, me vendim ta ndërpresë shpalljen e tij, me të cilin do t'i arsyetojë shkaqet e ndërprerjes. Këshilli është i obliguar, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes të këtij vendimi, ta shqyrtojë vendimin dhe të vendos në lidhje me të. Nëse këshilli e vërteton dispozitën, prefekti është i obliguar ta shpallë dhe njëkohësisht të paraqesë iniciativë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së dispozitës së kontestuar para Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për këtë iniciativë, prefekti është i obliguar që ta informojë ministrinë kompetente për kryerjen e punëve që i përkasin qeverisjes lokale⁴⁶.

Lidhur me ndërprerjen e mandatit të prefektit, ligji në fuqi përcakton se, prefektit i ndërpritet mandati sipas fuqisë së ligjit:

- nëse paraqet dorëheqje;
- në rast vdekjeje;
- nëse me vendim të plotëfuqishëm është i dënuar për vepër penale me dënim me burg në kohëzgjatje mbi gjashtë muaj;
- nëse me vendim të plotëfuqishëm i merret e drejta e zotësisë së veprimt;

⁴⁴ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 52.

⁴⁵ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 53.

⁴⁶ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 51.

-nëse paraqitet gjendja e papërputhshmërisë për kryerjen e funksionit në pajtim me Ligjin për zgjedhje lokale;

-në rast të mungesës së paarsyeshme më gjatë se gjashtë muaj dhe nëse pushon të jetë banor i komunës⁴⁷.

Prefekti miraton vendime në procedurë administrative në shkallë të parë. Me ta, ai vendos për realizimin e të drejtave, detyrimeve ose interesave të veçanta të qytetarëve nga territori i komunës së tij, të cilat parashikohen me ligj ose akt tjetër të përgjithshëm, dhe janë në kompetencën e qeverisjes lokale. Kundër vendimeve të kryetarit të komunës lejohet ankesë, sipas së cilës vendos ministria përkatëse. Nëse ankesa nuk lejohet sipas dispozitës ligjore, atëherë vendimi i tillë i kryetarit është përfundimtar dhe, kundër tij, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi me të cilën hapet konflikti (kontesti) administrativ para Gjykatës Administrative me seli në Shkup⁴⁸.

2.3 Dominimi i fuqisë së Kryetarit të Komunës në strukturën e kompetencave komunale

Organi ekzekutiv brenda njësisë së qeverisjes lokale është Kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës është një organ individual i njësisë së qeverisjes lokale me një rol të theksuar në funksionimin e saj. Pozicioni i tij forcohet veçanërisht nga mënyra e zgjedhjes së tij. Gjegjësisht, ai/ajo zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë në përputhje me ligjin. Në atë mënyrë, ky organ e merr mandatin direkt nga qytetarët, përkatësisht nga votuesit, siç është rasti me anëtarët e këshillit të njësisë së qeverisjes lokale. Me këtë, ky organ merr mundësi të zhvillohet në një ekzekutues kryesor të punëve të njësisë së qeverisjes lokale. Kryetari zgjidhet për një mandat prej katër vjet pa kufizime në rizgjedhjen në këtë post. Në praktikën aktuale të qeverisjes locale në RMV, ka shembuj kur persona të caktuar ishin kryetarë të komunave në tre, madje në katër mandate. Ndryshe nga anëtarët e këshillit të njësisë së qeverisjes lokale, funksioni i kryetarit kryhet në mënyrë profesionale. Kjo do të thotë

⁴⁷ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 54.

⁴⁸ Për më tepër shih në: Борче Давитковски; Ана Данева-Павловска, Административно право (Прв дел: Материјално право), Скопје: 2018, стр. 86.

se asnjë veprimtari tjetër profesionale nuk mund të ushtrohet gjatë kryerjes së funksionit të Kryetarit të Komunës⁴⁹.

Dominimi i kompetencave dhe i fuqisë së kryetarit të komunës (prefektit) në strukturën e kompetencave të qeverisjes lokale si dhe në qasjen e resurseve të tij, ndikoi në paraqitjen dhe përforcimin e një modeli të vërtetë monopolist monokratik të pushtetit dhe të fuqisë në udhëheqjen e politikave lokale dhe në shfrytëzimin e resurseve publike të bashkësive lokale. Në periudhën kohore deri në vitin 2005 e, sot edhe më tepër, pothuajse krejt kompetencat dhe fuqia e qeverisjes lokale në RMV po përqendrohet në pozicionin e prefektit. Prefekti përveç asaj që është funksionari i vetëm ekzekutivo-administrativ, ai merr pjesë edhe në funksionin normativ ("ligjvënës") të bashkësisë lokale në atë mënyrë që është propozues i autorizuar i vendimeve të Këshillit të asaj bashkësie. Ai udhëheq me shërbimet profesionale dhe administratën e njësisë së qeverisjes lokale. Të punësuarit në ato organe drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të plotë varen nga prefekti. Ai vendos për të drejtat e personave juridikë dhe fizikë në procedurë administrative. Prefekti i emëron dhe i shkarkon drejtorët dhe organet e qeverisjes lokale. Ai e siguron shfrytëzimin dhe mbrojtjen e pronës së qeverisjes lokale. Prefekti është ekskluzivisht kompetent për përmbarimin (ekzekutimin) e vendimeve të këshillit. Ai është kompetent edhe për përmbarimin e buxhetit të njësisë së qeverisjes lokale, duke pasur kompetencë të plotë mbi politikën e përmbarimit dhe udhëheqjes me punët e qeverisjes lokale. Nga ana tjetër, prefekti, me asgjë nuk varet nga këshilli i njësisë së qeverisjes lokale dhe, poashtu nuk varet me asgjë edhe nga qytetarët mbase për atë nuk është paraparë as impiçmenti e as revokimi. Pra, përderisa është gjallë dhe shëndosh e mirë dhe, përderisa në kuptimin formal-juridik u përmbahet ligjeve, gjë që është e lehtë për t'u realizuar, atë askush nuk mund ta ndërrojë pa marrë parasysh se ai/ajo mund të humb autoritetin dhe legjitimitetin e funksionarit publik (funksionarit që është në shërbim të interesave publike të qytetarëve dhe popullsisë lokale). Përballë një pozicioni të tillë të prefektit, këshilli i njësisë së qeverisjes lokale ka një pozicion ndjeshëm më të dobët. Këshilli miraton akte dhe vendime, duke rregulluar disa lëmi dhe çështje në mënyrë të përgjithshme me çka e normon kornizën e politikave lokale. Kuptohet se kjo gjë, paraqet një dimension mjaft të rëndësishëm për jetën dhe intereset e

⁴⁹ Për më tepër shih në: Силјановска-Давкова, Митков, Каракамишева-Јовановска, Спасеновски, Кртолица, Локална самоуправа, Скопје, стр. 308.

bashkësisë lokale dhe për funksionimin e qeverisjes lokale, mirëpo, determinimi i parë dhe kryesor i atyre akteve dhe i vendimeve është propozimi i tyre, pra, përkufizimi i dispozitivit të vendimeve, argumentacionit/arsyetimit dhe rezultatet e përmbartimit të tyre. Krejt këtë e përgatit dhe e siguron shërbimi profesional dhe administrata e qeverisjes lokale, ndërkaq, e verifikon, e propozon dhe e realizon prefekti. Pra, selektimi i mundshëm i prioriteteve dhe i argumenteve ndodhet në pushtetin dhe në fuqinë e prefektit. Në këtë drejtim, poashtu është e mundshme edhe konsekuenca e krejt kësaj situate, që konsiston në selektimin e intereseve duke mos i përfillur interesat e përgjithshme dhe të përbashkëta të bashkësisë lokale dhe të qytetarëve. Një gjë e tillë është më se reale, në kushte kur dominojnë interesat e veçanta partiake, klanore, kriminale apo të grupeve të biznesit, që paraqiten si një realitet në një numër të madh të rasteve brenda për brenda eksperiencës së këtij modeli të qeverisjes lokale në RMV. Në mënyrë plotësuese, mozaiku i tillë rrumbullakohet më faktin se, vetë qytetarët janë subjekti më i dobët në konceptin e qeverisjes lokale në RMV. Qytetarët pas aktit të zgjedhjeve lokale nuk kanë kurfarë pozicioni apo qasje në praktikimin e qeverisjes lokale. Institutet e demokracisë së drejtpërdrejtë, siç janë: iniciativat dhe tubimet e qytetarëve, siç u morr vesh, janë modele tepër të dobëta për rolin e qytetarëve në qeverisjen lokale në RMV. Këto mekanizma janë difuze, shumë rëndë vihen në lëvizje dhe si një kapak i kësaj, krejt ajo që mund të del si konkluzë e tyre, nuk i detyron organet e qeverisjes lokale. Pra, çdo përpjekje e aktivizmit lokal të qytetarëve, varet nga konstatimi dhe vullneti i prefektit dhe i këshillit të komunës. Krejt ky domen i participimit të qytetarëve në qeverisjen lokale paraqet një domen që ri i varur në ajër, pa mekanizma të duhur për ndikim efektiv ndaj organeve të qeverisjes lokale. Deri në vitin 2002, pra, deri para hyrjes në fuqi të Ligjit në fuqi për qeverisjen lokale, qytetarët kishin mundësi që të votonin lidhur me mocionin e votëbesimit të prefektit, të cilin vetë e kanë zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta. Ky instrument paraqiste një mundësi për të provuar legjitimitetin e prefektit si dhe për të sendërtuar verifikimin demokratik të punës së tij nga aspekti i intereseve të popullsisë lokale. Mirëpo, ky instrument, u shfuqizua me ligjin në fuqi të vitit 2002, kështu që, sot, normativisht dhe praktikisht, është në fuqi pozicioni i paprekshëm i prefektit. Në pozicionin e qytetarëve ka ngelur ende referendumi me të cilin mund të ndikohet në organet e qeverisjes lokale për një çështje të caktuar. Mirëpo, ky

instrument, aq rrallë është zbatuar sa që edhe emri dhe kuptimi i është harruar. Edhe përkundër preferimit (rekomandimit) të tij si një praktikë dhe politikë e përgjithshme evropiane (sipas Kartës evropiane për qeverisje lokale), referendumi lokal nuk arriti të nikoqirëzohet në sistemin e qeverisjes lokale të RMV-së. Referendumin lokal nuk e zbatojnë edhe partitë politike në kuadër të politikës së tyre lokale, gjë që flet mjaft për preferimin e rolit partiak përpara rolit të qytetarëve në kuadër të politikave lokale, gjë që paraqet edhe një indikator për disa dukuri të tjera. Për këto arsye, por, jo vetëm kaq, funksioni i prefektit filloi të perceptohet si një funksion mjaft i kërkuar (i pëlqyer) dhe si një biznes profitabil e, jo si një funksion publik në interes të përgjithshëm të qytetarëve dhe të bashkësisë lokale, kuptohet me një kompensim të duhur ligjor dhe legjitim në planin financiar dhe moral për bartësin e këtij funksioni. Në këtë drejtim, pa ndonjë gabim të madh, mund të konstatohet se, motivacioni për t'u bërë prefekt është i zhvendosur kah benefitet dhe favoret personale, kah benefitet e partisë politike amë të prefektit si dhe kah benefitet e strukturës së tij biznesore. Në suaza të këtij trendi, dita-ditës po bëhet i dukshëm orientimi i prefektit për të promovuar ekipet, trupat apo ekipet e tij jo formale dhe jashtë institucional, më çka ky funksion publik po merr përmasa drastike të një menaxhimi privat apo të një menaxhimi që i përzien punët publike me ato private, gjë që kuptohet se është në kundërshtim me esencën dhe frymën e qeverisjes lokale dhe pozicionin e prefektit në strukturën e saj. Thënë në përgjithësi, pozicioni i prefektit, ashtu siç është sot, do të ndikojë dukshëm në drejtim të asaj që qeverisja lokale në RMV edhe një kohë të gjatë të mos realizohet si një parim demokratik dhe si një e drejtë reale e qytetarëve dhe bashkësive lokale, për arsye se, tani për tani, prefekti është treguar më tepër si një faktor i oligarkizimit të qeverisjes lokale se sa, si një faktor i demokratizimit të saj. Me një tendencë të tillë, që është e pranishme në shumë komuna, edhe më tej, do mbetet retorika boshe si dhe keqpërdorimi i interesave lokale nga ana e qarqeve të ndryshme klanore, oligarkike, partiake, biznesore, etj⁵⁰.

2.4 Raportet midis pushtetit qëndror dhe lokal

Ligji në fuqi për qeverisjen lokale, fillimisht përcakton llojet dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes. Lloji i mbikëqyrjes varet nga lloji i kompetencës. Kur bëhet fjalë për kompetencën burimore komunale, atëherë mbikëqyrja shtrihet mbi ligjshmërinë e akteve dhe të veprimeve si

⁵⁰ Për më tepër shih në: Jeton Shasivari, Vepra e cituar, fq. 317-320 dhe: Владо Поповски, Vepra e cituar, fq. 361-376.

dhe të punës materiale dhe financiare, ndërsa te kompetencat e deleguara, mbikëqyrja shtrihet edhe mbi efikasitetin e punës. Nga ana tjetër, në raste të parashikuara me ligj, paraqitet edhe mbikëqyrja paraprake në kuptimin e pëlqimit paraprak ndaj dispozitave të komunës.

Kështu, mbikëqyrja mbi punën e organeve të komunës në kryerjen e kompetencave të saj e përfshinë mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë, kontrollin dhe revizionin mbi punën materiale dhe financiare. Mbikëqyrja mbi punën e organeve të komunës mbi kryerjen e punëve të deleguara nga kompetencat e organeve të administratës shtetërore e përfshinë mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë dhe mbikëqyrjen mbi efikasitetin. Në rastet e përcaktuara me ligj, bëhet edhe mbikëqyrja paraprake e cila e përfshinë pëlqimin paraprak të dispozitave të komunës. Mënyra dhe veprimi i kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunës është përcaktuar me ligj. Organet e komunës janë të obliguara të bashkëpunojnë me organet për kryerjen e mbikëqyrjes⁵¹.

Lidhur me organet për kryerjen e mbikëqyrjes, ligji në fuqi përcakton se, mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e dispozitave të komunës e kryen Ministria kompetente për kryerjen e punëve të qeverisjes lokale. Mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e punës së organeve të komunës e kryejnë organet e administratës shtetërore. Kontrollin e punës materiale dhe financiare të komunës e kryen Ministria për financa. Revizionin mbi punën materiale dhe financiare të komunës e kryen Enti shtetëror për revizion në përputhje me ligjin për revizion shtetëror. Mbikëqyrjen mbi kompetencat e deleguara e kryen organi i administratës shtetërore kompetencat e të cilit i janë deleguar komunës⁵².

Ligji në fuqi për qeverisjen lokale, rregullon edhe çështjen e mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë e dispozitave të komunës. Kështu, prefekti është i obliguar, në afat prej 10 ditësh nga dita e publikimit të dispozitave të komunës, t'i dorëzojë ato deri te Ministria kompetente për kryerjen e punëve të qeverisjes lokale. Nëse ky organ çmon se dispozita nuk është në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në afat prej 45 ditësh nga dita e dorëzimit të dispozitës, sjell vendim për ndërprerjen e zbatimit të dispozitës, me çrast i arsyeton edhe shkaqet e ndërprerjes, dhe ky vendim publikohet në: "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Organi në fjalë, në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të këtij vendimi, deri te

⁵¹ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 69.

⁵² Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 70.

Gjykata kushtetuese paraqet iniciativë për vlerësimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së dispozitës së ndaluar. Nëse procedura nuk ngritet në afatin e përcaktuar, atëherë ndërpritet vlefshmëria e vendimit për ndalesën e zbatimit të dispozitës së ndaluar dhe, kjo dispozitë bëhet ekzekutive⁵³.

Poashtu, sipas ligjit në fuqi, Enti shtetëror për revizion, kryen revizione të rregullta të llogarive financiare të komunave në përputhje me ligjin. Prefekti është i obliguar, në afat prej 30 ditësh nga dita e sjelljes, t'ia dorëzojë raportet për kryerjen e buxhetit dhe llogarinë përfundimtare të komunës Entit shtetëror për revizion. Raporti përfundimtar për revizionin i kryer iu dorëzohet organeve të komunës, ministrit kompetent për punët e qeverisjes lokale dhe ministrit për financa. Nga ana tjetër, nëse gjatë sjelljes së dispozitës së komunës kërkohet pëlqimi paraprak nga organi tjetër, organi pëlqimin e jep më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita kur i është dorëzuar propozim dispozita. Nëse pëlqimi paraprak nuk merret brenda këtij afati, dispozita konsiderohet si e pranuar ashtu siç ka qenë e propozuar nga komuna⁵⁴.

2.5 Demokracia lokale dhe transparencja

Ligji në fuqi parasheh tri forma të demokracisë së drejtpërdrejtë lokale, edhe atë: iniciativën qytetare, tubimin e qytetarëve dhe referendumin.

Lidhur me iniciativën qytetare, sipas ligjit në fuqi, qytetarët kanë të drejtë t'i propozojnë këshillit që të sjell akt të caktuar ose të zgjedh një çështje të caktuar nga kompetencat e veta. Iniciativë qytetare nuk mund të paraqitet për çështje kuadroviqe dhe financiare. Për propozimin në fjalë, këshilli është i obliguar që të debatojë nëse e mbështesin më së paku 10% e zgjedhësve të komunës, respektivisht të qeverisjes vendore të cilës i dedikohet çështja e përcaktuar. Këtë debat, këshilli është i obliguar ta mbajë më së voni në afat prej 90 ditësh pas iniciativës së dorëzuar dhe t'i informojë qytetarët për vendimin e vet⁵⁵.

Lidhur me tubimin e qytetarëve, sipas ligjit në fuqi, tubimi i qytetarëve mund të thirret për territorin e mbarë komunës ose për territorin e qeverisjes vendore. Tubimin e qytetarëve e thërret prefekti i komunës me iniciativë të vet, me kërkesë të këshillit ose me kërkesë të më së

⁵³ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 71.

⁵⁴ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, nenet 72-73.

⁵⁵ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 26.

paku 10% të zgjedhësve të komunës, respektivisht të qeverisjes vendore të cilës i dedikohet çështja e përcaktuar. Organet e komunës janë të obliguara që në afat prej 90 ditësh t'i shqyrtojnë konkluzat e sjellura në tubimin e qytetarëve dhe t'i marrin parasysh gjatë marrjes së vendimeve dhe sjelljes së masave lidhur me çështjet që u dedikohen, si dhe t'i informojnë qytetarët për vendimet e veta⁵⁶.

Lidhur me referendumin, sipas ligjit në fuqi, qytetarët përmes referendumit mund të vendosin për çështje nga kompetencat e komunës, si dhe për çështje të tjera me rëndësi lokale. Këshilli është i obliguar të shpall referendumin me kërkesë të më së paku 20% të zgjedhësve në komunë. Këshilli mund të shpall referendumin për çështje nga kompetencat e veta me iniciativë të vet. Vendimi i dalur nga referendumi është obligues për këshillin⁵⁷.

Në këtë drejtim, ligji në fuqi, me qëllim të fuqizimit të shoqërisë civile dhe të përgjegjësisë së pushtetit publik komunal, parasheh edhe forma të tjera të pjesëmarrjes, edhe atë: parashtresat dhe propozimet si dhe tribunat e hapura dhe anketat. Kështu, çdo qytetarë ka të drejtë, vet ose bashkë me të tjerët të paraqesë parashtresa dhe propozime për punën e organeve të komunës dhe administratës komunale. Prefekti është i obliguar:

- të krijojë kushte për paraqitjen e parashtresave dhe propozimeve;
- më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të parashtresës, respektivisht propozimit, parashtruesit t'i dorëzojë përgjigje me arsyetim; dhe

- parashtresat dhe propozimet që nuk kanë të bëjnë me punët nga kompetencat e organeve të komunës t'i dorëzojë deri tek organi kompetent dhe për këtë ta njoftojë parashtruesin. Gjatë hartimit të dispozitave të komunës, këshilli, respektivisht prefekti mund paraprakisht të organizojë tribuna publike, të realizojë anketa ose të kërkojë propozime nga qytetarët⁵⁸.

⁵⁶ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 27.

⁵⁷ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 28.

⁵⁸ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, nenet 29-30.

Në këtë drejtim, kur flitet për demokracinë lokale, transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në RMV, duke u bazuar në hulumtimet empirike të kësaj çështjeje⁵⁹, duhet theksuar gjetjet empirike në vijim:

-Shumë pak qytetarë të anketuar (12% sish) mund të marrin pjesë personalisht në hartimin e politikave lokale me iniciativat e tyre;

-Qytetarët nuk janë aktivë në nivel të mjaftueshëm;

-Arsyet kryesore për një pasivitet të tillë janë: "pa kohë (i zënë)" dhe "askush nuk më pyet, duke mos më kërkuar asgjë". Pjesëmarrja me përqindje të lartë ndodh edhe në modalitetin "Unë nuk e di dhe nuk kam përgjigje";

-Qytetarët besojnë se pushteti lokal, së bashku me udhëheqjen lokale, duhet të kenë rolin më të madh në favor të pjesëmarrjes qytetare në demokracinë lokale;

-Qytetarët janë të distancuar, në çdo pikëpamje, nga përfaqësuesit e tyre në organet e qeverisjes lokale, posaçërisht në komunat më të mëdha;

-Është indikative që, qytetarët aspak nuk janë të kënaqur me punën e administratës komunale (në 80% të rasteve);

-Qytetarët nuk janë mjaftueshëm aktivë në përdorimin e instituteve të demokracisë lokale, dhe, që ata të jenë aktivë, nuk ka dyshim se, të gjitha institucionet duhet të depolitizohen dhe të departizohen, me atë që, qytetarët duhet të jenë më të informuar dhe më të afërt me institucionet⁶⁰, dhe

-Të zvogëlohet censusi i kërkuar nga qytetarët për të ushtruar të drejtën e tyre për vendimmarrje të drejtpërdrejtë. Hulumtimet e mëparshme kanë treguar se censusi prej 10% për iniciativën qytetare dhe tubimin e qytetarëve si dhe censusi prej 20% për referendumin, janë mjaftë të lartë dhe, qytetarët nuk mund të ngrejne çështje të veçanta në kuadër të demokracisë lokale. Duke marrë parasysh faktin se, në shumicën e shteteve ky census është rreth 5%, konsiderohet se, ai duhet të aplikohet edhe në RMV për iniciativën qytetare dhe tubimin e qytetarëve, ndërsa, censusi për referendumin të jetë 10%. Po ashtu, nëse realizohet

⁵⁹ Për më tepër shih në: Мирјана Динева-Сланинка, "Граѓаните и институциите на локалната самоуправа (Истражувачки резултати и расправа)", Институт за социолошки и политичко-правни истражувања, УКИМ-Скопје, 2011, стр. 77-101.

⁶⁰ Ibid.

referendumi, atëherë ai të jetë i suksesshëm nëse në referendum dalin më shumë se 30% nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve në komunë, me çrast pozitivisht të deklarohen më shumë se gjysma e zgjedhësve që kanë votuar⁶¹.

2.6 Mbrojtja juridike kushtetuese e autonomise lokale në RMV

Për pozicionin dhe rolin real të qeverisjes lokale në sistemin kushtetues dhe politik, nuk mjafton që ajo të garantohet nga Kushtetuta. Fakti që qytetarëve u garantohet me Kushtetutë e drejta për qeverisje lokale nuk do të thotë se ajo do të realizohet. Në fakt, realizimi i qeverisjes lokale mund të sigurohet vetëm kur qytetarëve dhe njërive të qeverisjes lokale u sigurohen mjete dhe instrumente ligjore dhe të tjera për mbrojtjen e qeverisjes lokale në rast se kjo e drejtë e qytetarëve është e shkelur ose e kufizuar. Nëse nuk sigurohet mbrojtja e qeverisjes lokale, atëherë ky institucion mund të mbetet një deklaratë e thjeshtë. Nga ana tjetër, mbrojtja e qeverisjes lokale është edhe më e rëndësishme dhe e suksesshme nëse siguron realizimin sa më efikas të qeverisjes lokale në sistemin real kushtetues dhe politik.

Në këtë kontekst, Ligji përcakton tre parime themelore në bazë të të cilave realizohet mbrojtja e qeverisjes lokale.

Sipas parimit të parë, këshilli i njësisë së qeverisjes lokale, si dhe kryetari i komunës, mund të paraqesin një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore, pozita dhe të drejtat e njësisë së vetëqeverisjes lokale të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.

Sipas parimit të dytë, njërive të qeverisjes lokale u garantohet mbrojtja gjyqësore para gjykatave kompetente në lidhje me aktet dhe aktivitetet e organeve të administratës shtetërore dhe Qeverisë së Republikës, të cilat pengojnë kryerjen e kompetencave të vetë lokale.

Së fundmi, sipas parimit të tretë, njësitë e qeverisjes lokale duhet të konsultohen në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes për çështjet që lidhen me to. Për më tepër, njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet të konsultohen për

⁶¹ Për më tepër shih në: Илија Тодоровски, “Позначајни развојни трендови на македонската локална самоуправа во периодот на деволуцијата”, Институт за социолошки и политичко-правни истражувања, УКИМ-Скопје, 2011, стр. 74-75.

planifikimin e punëve publike gjatë përgatitjes së planit hapësinor të Republikës. Kështu, njësi të qeverisjes lokale u jepet mundësia të veprojnë në mënyrë parandaluese në drejtim të mbrojtjes së vetëqeverisjes lokale⁶².

Pra të rezimojmë, qeverisja lokale gëzon dy lloje të mbrojtjes juridike, edhe atë: mbrojtjen e pozitës kushtetuese të komunës dhe mbrojtjen gjyqësore të komunës. Lidhur me mbrojtjen e pozitës kushtetuese të komunës, këshilli dhe prefekti mund të paraqesin para Gjykatës kushtetuese iniciativë për vlerësimin e kushtetueshmërisë së ligjeve dhe kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore me të cilat çrregullohet pozita kushtetuese e komunës e përcaktuar me kushtetutën dhe ligjet⁶³. Nga ana tjetër, lidhur me mbrojtjen gjyqësore të komunës, komunave u garantohet mbrojtja gjyqësore para gjykatave kompetente lidhur me aktet dhe aktivitetet e organeve të administratës shtetërore dhe Qeverisë së Republikës me të cilat pengohet kryerja e kompetencave të përcaktuara me ligj⁶⁴.

⁶² Për më tepër shih në: Силјановска-Давкова, Митков, Каракамишева-Јовановска, Спасеновски, Кртолица, Локална самоуправа, Скопје, стр. 337-338.

⁶³ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 87.

⁶⁴ Ligji për qeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002, neni 88.

KAPITULLI I TRETË

KAPACITETET E DECENTRALIZIMIT DHE TRANSPRENCËS SË KOMUNËS SË STUDENIÇANIT- STUDIM RASTI

3.1 Struktura territoriale dhe historiku I komunës së Studeniçanit

Komuna e Studeniçanit zë pjesën jugore dhe jugperëndimore të luginës së Shkupit, si një zonë e dikurshme e komunës së Kisela Voda. Në territorin e tij buron lumi Kadina. Zona e kësaj komune ka një shumëllojshmëri të strukturave të relievit, pasi që shumica e saj është kodrinore - malore, e vendosur midis maleve të Gushenicës dhe Karadzicës, d.m.th. i përket vargmalit Jakupica. Kufizohet me komunat Sopishtë, Kisela Voda, Zelenikovo, Çashka, Makedonski Brod dhe Petrovec.

Territori i Komunës së Studeniçanit përfshin një sipërfaqe prej 274 km² dhe është një nga komunat e mesme në Republikë. Dendësia mesatare e popullsisë është 62 banorë për km², që është një mesatare relativisht e mirë për sa i përket natyrës kodrinore dhe malore të komunës. Komuna e Studeniçanit ka 19 vendbanime, 18 prej të cilave ekzistojnë dhe një fshat është zhvendosur plotësisht (Kaldirec). Vendndodhja dhe selia qendrore e komunës është Studenicani me 4.582 banorë. Vendbanimet e tjera janë: Batinci, Drachevica, Dolno Kolicani, Gorno Kolicani, Crvoda Voda, Aldinci, Cvetovo, Elovo, Crn Vrv, Markova Sushica, Vrtkica, Malchishte, Umovo, Pagarusha, Osinchani and Ramini. Më i madhi prej tyre është Batinca me 4,109 banorë.⁶⁵

Historiku i Komunës

Lugina e Shkupit në të cilën ndodhet rajoni i planifikimit të Shkupit, i cili sot i përket Komunës së Studeniçanit, dikur, si tani, kishte një pozicion qendror brenda Ballkanit të Mesëm. Në të kaluarën e largët, Lugina e Shkupit ishte në mes të rrugës ndërmjet lëvizjeve të Vardarit dhe Moravian si një kryqëzim rrugësh madhore nga veriu në jug dhe perëndimi në lindje si një lidhje midis Kosovës dhe perëndimit - luginat maqedonase nga njëra anë dhe lindja - luginat maqedonase nga ana tjetër. Kjo krijon rëndësinë qendrore gjeo - politike të luginës së

⁶⁵ Për më tepër shih në ueb faqen zyrtare të Komunës së Studeniçanit: <http://studenicani.gov.mk/> (Qasur më 29.11.2020).

Shkupit e cila ka pasur një ndikim të thellë në historinë politike dhe kulturore të këtij rajoni, si dhe në kontaktet dhe ndikimet e rajoneve të tjera të rëndësishme të së kaluarës.

Para ardhjes së Romakëve, d.m.th. më V dhe IV para erës sonë ka pasur përpjekje për të urbanizuar vendbanimet dhe janë ndërtuar vendbanime të fortifikuara që mbështeteshin në përvojat helene dhe në shembuj nga Egjeu dhe Mesdheu Lindor. Këto vendbanime janë përpjekur të planifikojnë brendësinë, të maksimizojnë funksionalitetin e saj, ta formësojnë atë estetishtë dhe për një fortifikim të një cilësie më të mirë. Nga kjo periudhë është qyteti ("Isar" - Kale) afër Studeniçanit. Muret mbyllnin një sipërfaqe prej 2.5 hektarë, por pasuria e gjetjeve lëvizëse e veçon atë nga vendet e tjera në rajonin e Shkupit - përveç argjendarisë, vazove luksoze prej argjendi dhe bronzi, vazo të pikturuara të tipit Attic, armë, pitos të mëdhenj. Prodhimi lokal i vazove të pikturuara për modelin e mallrave të importuara nga jugu konfirmohet gjithashtu këtu. Gjithashtu në Studeniçan, sipër partive të shtëpisë u gjetën koka në formë palmetto-antefiksi. Përveç qytetit të Studeniçani, në territorin e komunës së tanishme të Studeniçanit gjenden edhe depozitat "Vrnjak" në Markova Sushica. Këto qytete të fortifikuara nga periudha para-helenistike nuk vdisnin për shkak të pushtimeve galike në fund të shekujve IV dhe fillimit të shekujve III para erës sonë si dhe pushtimin e dardanëve nga veriu i Kosovës në të njëjtën periudhë. Dardanasit mbetën në këto zona deri në ardhjen e Romakëve. Me epokën romake dhe ardhjen e romakëve në shekullin III dhe II para erës sonë filloi urbanizimi i vërtetë i Luginës së Shkupit. Qytetet që u krijuan në atë kohë ishin ndërtuar sipas parimeve italo-romake me një skemë të brendshme, me një plan urbanistik të ndërtesave publike, me një sistem komunitar-higjienik, me rrugë të shtruara, kanalizime, ujësjellës, etj.

Përveç rrugëve, është e njohur në histori se Romakët i dhanë një rëndësi të veçantë ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për rajonin e Shkupit pasi rrugët romake janë përdorur në kohën e vonë romake dhe të hershme bizantine për të kushtëzuar zhvillimin ekonomik dhe kulturor të rajonit-qendrat tregtare u ndërtuan në kryqëzime me kulla vrojtimi dhe qytete të fortifikuara. Në periudhën nga v. I deri në VI një numër vendbanimesh dhe kështjellash janë ndërtuar në territorin e komunës aktuale të Studeniçanit, të cilat tregojnë për popullsinë e vazhdueshme të kësaj zone, si dhe zhvillimin

antik të popullsisë së atëhershme. Vendbanime dhe kala të tilla janë "Kale" dhe "Mumdzica" në Albinci, "Gradishte" në Dolno Kolicane, "Kale" në Dracevica, "Isar" në Elovo, "Kalja" në Crni Vrv.

Gjatë vendosjes së sllavëve nuk kishte gjetje të shkruara apo kulturore. Historia e mesjetës për rajonin e Shkupit daton që nga fundi i shekullit X-të me mbretërimin e Car Samoil kur Shkupi dhe rrethinat e tij ishin një pikë e rëndësishme strategjike e mbrojtjes. Me fitoren e fundit bizantine mbi Car Samoil, Shkupi dhe rrethina u bënë një vend i rëndësishëm i një njësie më të madhe menaxhimi. Periudha nga shekulli X deri në XIV - periudha bizantine-sllave - ka një rëndësi të veçantë për historinë mesjetare të këtij rajoni. Rëndësia ekonomike e Shkupit është veçanërisht e rëndësishme pasi Shkupi ishte një kështjellë strategjike dhe kufitare. Shumë rrugë rajonale u prenë në rajonin e Shkupit dhe Shkupi ishte një degë kufitare bizantine për në Evropë dhe një seli e rëndësishme tregtare e Ballkanit. Shkupi në atë kohë kishte dy elemente - pjesën ushtarake-administrative dhe pjesën civile. Trashëgimia kulturore dhe shpirtërore gjithashtu varej prej tyre.

Kommenosi Bizantin i Shekullit XII është unik në stilin e tij të krijimtarisë në të gjithë Ballkanin dhe sot e kësaj dite ka tërhequr interes të paparë. Baza shpirtërore e krishterë e mëvonshme në stilin bazilik dhe baza e një kryqi të mbishkruar janë karakteristike. Por, një gjë është e rëndësishme të thuhet për periudhën pas Bizantine: Duke forcuar Shkupin si një qendër strategjike ekonomike dhe politike, rrethinat e Shkupit, ku i përket bashkisë së tanishme të Studeniçanit, janë lënë pas dore. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe themelimit të Jugosllavisë, territori i Komunës së Studeniçanit i përket komunës së atëhershme të Kisela Voda. Në Shtator 1996 u miratua Ligji për Ndarjen e Re Territoriale të Republikës së Maqedonisë, duke themeluar 123 komuna nga 34 ekzistuesit e mëparshme, dhe Qyteti i Shkupit me Asamblenë e Qytetit. Tri komuna të reja të Zelenikovo, Studeniçani dhe Sopishte dolën nga komuna ekzistuese e Kisela Voda⁶⁶.

⁶⁶ Për më tepër shih në ueb faqen zyrtare të Komunës së Studeniçanit: <http://studenicani.gov.mk/> (Qasur më 30.11.2020).

3.2 Profili i Komunës së Studeniçanit

3.2.1 Kryetari i Komunës

Kryetari aktual i komunës është Azem Sadiku. Azem Sadiku u lind më 1 shkurt, 1971, në Studeniçan. Shkollën fillore e kreu në SHF Naim Frashëri” në Studeniçan ndërsa të mesmen në gjimnazin matematiko-natyror “Xhevdet Doda” në Prishtinë. Studimet i ka vazhduar në Shkup në Universitetin “MIT” në drejtimin e biznes-menaxhmentit. Ka punuar si kontabilist në ndërmarrjen familjare. Nga viti 2000-2005 ka qenë Kryetar i komunës së Studeniçanit. Në periudhën prej 2007-2009 ka qenë drejtor i Shtëpisë së studentëve, Pellagonia” në Shkup. Ndërsa pastaj sërish u zgjodh kryetar i Komunës së Studeniçanit në mandatin e dytë në periudhën prej 2013-2017. Qytetarët e Komunës së Studeniçanit i dhanë besimin që për here të tretë të zgjidhet kryetar i Komunës së Studeniçanit për periudhën 2017-2021. Është i martuar dhe baba i katër fëmijëve⁶⁷.

Kryetari zgjidhet me zgjedhje të përgjithshme direkte me votim të fshehur në përputhje me ligjin për afat kohor 4-vjeçar. Kryetari detyrën e tij e kryen në mënyrë profesionale. Kryetari në kornizën e detyrave:

- e përfaqëson komunën
- kontrollon ligjshmërinë e akteve të këshillit
- i prezenton rregullat e këshillit në faqen zyrtare të komunës
- garanton implementimin e vendimeve të këshillit
- garanton kryerjen e obligimeve të cilat me ligj i janë leliguar komunës
- inicon dhe propozon sjelljen e rregullave në kompetencë të këshillit
- propozon buxhetin vjetor dhe llogarin vjetore të buxhetit komunal
- e realizon buxhetin e komunës
- emëron drejtor të ndërmarrjeve publike të cilat i themeloi komuna në bazë të konkursit publik
- sjell vendim për përcaktimin e tatimit të pronës që gjendet në teritorin e saj
- mban evidencë për restorantet si edhe për orarin e punës së tyre të cilat punojnë në teritorin e saj

⁶⁷ Për më tepër shih në ueb faqen zyrtare të Komunës së Studeniçanit: <http://studenicani.gov.mk/> (Qasur më 30.11.2020).

-kontrakton objekte me qira ose pjes te objektit të institucioneve publike me ose pa pajisje

-obligohet menjëher ta informoj ministrin kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e vetqeverisjes lokale për ndodhjen njërit nga kushtet për shpërbërjen e këshillit

-gjatë lëshimit të parakohshëm të këshillit deri në zgjedhjen e këshillit të ri i kryen obligimet në kompetenc të këshillit me kufizime të përcaktuara me ligj

-përgadit rebalans të buxhetit me qëllim të kapërcimit të paqendrueshmëris financiare të komunës të cilin e miraton komisioni për kapërcimin e paqendrueshmëris financiare të komunës

-rregullisht lajmëron këshillin në kryerjen e obligimeve ne kompetenca që i ka në përputhje me ligjin

-vendos për çështje juridikë për drejtësi, detyrime dhe interesa për persona fizik dhe juridik në përputhje me ligjin

-sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale

-vendos për punsime, për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në administratën komunale nëqoftë se nuk është rregulluar ndryshe me ligj

-garanton drejtësi dhe shfrytëzim ligjor, mirëmbajtje dhe mbrojtje të pronësis së komunës në përputhje me ligjin dhe statutin kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe statut⁶⁸.

3.2.2 Këshilli i Komunës

Këshilli është organi përfaqësues i qytetarëve. Këshillin e përbëjn 15 (pesmbëdhjet) antarë-përfaqësues të zgjedhur në mënyr të përgjithshme dhe direkte me vota të fshehura. Mandati i antarëve të këshillit është 4 (katër) vjeçar. Këshilli zgjedh kryetarin nga radhat e këshillit me mandat katërvjeçar. Kryetari i këshillit i konvokon dhe i udhëheq seancat e këshillit, përkujdeset për organizimin dhe punën e këshillit si dhe i firmos vendimet që i sjell këshilli me afat kohor tre ditor nga dita e sjelljes së tyre dhe i dorzon te Kryetari për

⁶⁸ Për më tepër shih në ueb faqen zyrtare të Komunës së Studeniçanit: <http://studenicani.gov.mk/> (Qasur më 30.11.2020).

publikim. Anëtarët e këshillit deklarajn dhe nënshkruajnë betimin solem teksti i të cilit është: “Unë (emri dhe mbiemri) bëj betimin solemn që të drejtat dhe detyrimet sia anëtar i këshillit do të i kryej me përgjegjësi dhe gjat realiyimit të tyre do ta respektoj kushtetutën, ligjet, vendimet e këshillit dhe do ta mbroj rendin kushtetues të Republikës së Maqedonis të Veriut”.

Kryetarit të keshillit në kryerjen e detyrës i ndihmon administrata e komunës. Këshilli i kryen këto obligime:

1 Sjell statutin e Komunës

2 Sjell rregulloren e këshillit

3 Sjell programin e punës

4 Sjell buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të Komunës

5 Vërteton shumën e burimeve të saja nga të hyrat, për financimin e komunës në kuadrin e definimeve ligjore.

6 Sjell plan detal dhe dokumentacion urbanistik për vendbanimin në që gravitojnë në Komunë.

7 Sjell program për regullimin e tokës ndërtimore

8 Sjell rregullore në fushën e mbrojtjes të mjedisit jetësor, asistencës sociale, mbrojtjen e fëmive, arsimit, mbrojtje shëndetsore, mbrojtje kundër zjarit në kuadër të detyrimeve të përcaktuara me ligje të veçanta ose në përputhje me programën nacionale.

9 Sjell program për mirëmbajtje rrugëve dhe rrugicave lokale

10 Sjell program për ndriçim publik

11 Sjell program për ndërtimi dhe mirmbajtje të ujsjellsit lokal

12 Sjell vendim për shfrytëimin e tregjeve publike

13 Rregullon mënyrën e pastrimit të oxhaqeve.

14 Rregullon hapsirën publike për parkim dhe mënyren e shfrytëimit të aspektit lokal

15 Sjell program mirëmbajtje dhe shfrytëimin parqeve dhe hapsirave tjera të aspektit lokal

16 Rregullon mirëmbajtjen e varrezave

- 17 Miraton program për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e koritave të lumit
- 18 Rregullon dhe organizon sferën e veprimit dhe mënyrën e kryerjes të detyrave të administratës së komunës me propozim të Kryetarit
- 19 Themelon ndërmarje publike dhe përcjell punën e tyre
- 20 Emëron antar të këshillave drejtues të shërbimeve publike që i themelon
- 21 Miraton program pune dhe plan financiar të ndërmarrjeve publike që ka themeluar
- 22 Miraton raport për realizimin e buxhetit dhe llogari vjetore të komunës, si edhe raport për realizimin e programës vjetore të komunës
- 23 Vendos për dhënien e lejeve për kryerjen veprimtarive të interesit publik të aspektit lokal në pajtim me ligjin
- 24 Miraton llogari vjetore dhe raportet e punës të ndërmarrjeve që ka themeluar
- 25 Vendos mënyrën e pronësisë që posedon komuna
- 26 Vendos për mënyrën e kryerjes të kontrollit financiar të buxhetit të komunës në përputhje me ligjin
- 27 Me vendim sjell vlerën e taksës komunale
- 28 Formon komision për vlersimin tatimit të vlerës së tregut, tatimin e pronësisë dhe i vendos shkallët tatimore
- 29 E rregullon orarin e punës të veprimtarive artizanale në varësi me traditat vendore në komunë
- 30 Bën planin e masave dhe aktivitetet që do të i merr për kapërcimin e joqëndrueshmërisë financiare të komunës i propozuar nga Kryetari që është përgjegjës për komunën
- 31 Zgjedh personin që do udhëheq me njësin rajonale të Ministrisë së brendshme në komunë në pajtim me ligjin
- 32 Analizon dhe miraton raportin vjetor të sigurimit publik në njësin komunale, të cilin e sjell Ministria e brendshme dhe avokati i popullit
- 33 Mund të i jep sugjerime personit që udhëheq me njësin rajonale të ministrisë së brendshme në sferën e sigurisë publike dhe të trafikut

34 Zgjedh dhe shkarkon kryetar të këshillit

35 Formon komisione të përkohshme

36 Realizon autorizime të veçanta ne përputhje me ligjin në bazë të të mirës publike dhe në bazë të pasurive natyrore në rajonin e komunës

37 Jep mirënjohje dhe dhurata komunale

38 Jep propozime për ligjet që sjellen në komunë

39 Bën zgjedhje dhe emërimë në kompetenca të saja

40 Sjell vendime tjera për punë në kompetenca të saja

41 Bën edhe punë tjera.

Këshilli mund të punoj nëse në seancë prezenton shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Këshilli vendos me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm në këshill, por jo më pak se një e treta të numrit të anëtarëve të këshillit, nëqoftese me statun nuk është e parapar shumicë e veçantë. Votimi ne seancë te këshillit është publik, përveç nëse këshilli nuk vendos për çështje të posaçme votimi të jet i fshehur. Statuti, buxheti, llogaria vjetore e buxhetit dhe rregullorja miratohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Seancë e jashtëzakonshme caktohet për çështje sigurie të qytetarëve, për gjëra që kanë ngjarë për shkak të rethanave të jashtëzakonshme (zjar, përmytje terrmet e tj) dhe gjatë vizitës të delegacioneve të huaja, kur përfaqses i të njejtave donë që të i drejtohet anëtarëve të këshillit. Sencë të jashtëyakonshme thëret kryetari i këshillit me vetë iniciativë, me propozim të 1/3 të anëtarëve të këshillit, ose me propozim të kryetarit. Ftesat për seancë dhe propozimie rendit të ditës iu dorzohet anëtarëve të këshillit në menyrën më të shpejt, para se të fillojn me punë anëtarët e këshillit votojn arsyen e caktimit të seancës pa hapur debat për materialin. Anëtarët e këshillit kan të drejt dhe detyrim të prezentojn dhe të marrin pjesë në punën e këshillit si dhe në komisionet e saja të përkohshme dhe të përhershme. Anëtarët në seancë të këshillit kanë të drejtë të japin i propozime dhe të i shtrojn pyetje Kryetarit të Komunës. Antari i këshillit nuk mund të merret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shprehur ose për votimin në këshill. Punëdhënësi është i detyruar ta lejoj nga puna profesionale anëtarin e këshillit për të prezentuar në seancën e këshillit dhe në komisionet ku ai është anëtar.

Anëtarët e këshillit kanë edhe të drejta dhe detyrime tjera të definuara me statut dhe rregullore tjera në pajtim me ligjin. Antari i këshillit nuk mund të merr pjesë në proceset e vendimit për çështjet ku ai ose partneri i jetës, fëmiu ose fqiu i shkalle së dytë në linjë ansore kanë interes financiar. Anëtari i këshillit është i detyruar që t'informoj këshillin për çështjet ku ai ka interes financiar ose interes personal. Anëtari i këshillit nuk mund të punsohet në administratën komunale në komunën ku ai punon. Me ditën e punësimit në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni do të konsiderohet se antari i këshillit ka dhënë dorëheqje. Anëtari i këshillit i punësuar në ndërmarrjet publike që i ka themeluar komuna nuk mund të merr pjesë në procesin e vendimarrjes për çështjet që vendosen në shërbimin (ndërmarrjen) publik ku ai punon. Anëtarit të këshillit i ndërpritet mandati para kohës që është zgjedhur:

- nëse jep dorëheqje

- në rast vdekje

- nëqoftëse është i denuar me vendim gjykatë për veprë penale me burg me afat kohor mbi 6 muaj

- nëqoftë se vinë në kundërthënie funksioni antar i këshillit në pajtim me ligjin të zgjedhjeve lokale.

- nëqoftë se me vendim gjykatë i është kufizuar një pjesë mundësive dhe nëqoftë se nuk është banor i komunës.

Komisionet e përhershme të këshillit janë:

- komisioni për formimin e buxhetit dhe zhvillimin rural ekonomik

- komisioni për urbanizëm, veprimtaritë komunale dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

- komisioni për shtëpi dhe shërbime publike.

- komisioni për statut dhe rregullore

- komisioni për mandate zgjedhje dhe emrim.

- komisioni për mirënjohje dhe dhurata.

- komisionet përbëhen nga 3 deri 5 anëtarë të këshillit

Komisionet në këshilli:

-debatojn për çështjet për të cilat janë formuar -japin mendime dhe propozime deri te këshilli

-i shqyrtojnë propozimet e kryetarit të komunës, anëtarëve të këshillit, iniciativat e qytetarëve për fushën për të cilën janë formuar⁶⁹

Tabela 2: Përbërja aktuale e këshillit të komunës:

1 Mujedin Abazi (PDSH)	2 Turkjan Saliu (PDSH)	3 Nefail Bilalovski (PDSH)
4 Sara Mustafa (PDSH)	5 Nehat Elmazi (BDI)	6 Kadir Rushidi (BDI)
7 Zejnepe Saqipi (BDI)	8 Kujtim Ferati (ASH)	9 Nusret Pashaliq (LSDM)
10 Elvira Mekiq (LSDM)	11 Xhevat Azemofski (LSDM)	12 Amit Memed (TDP)
13 Ibrahim Memedi (LB)	14 Azem Jonuzi (LB)	15 Zulejha Ali (LB)⁷⁰

3.2.3 Administrata komunale

Në administratën komunale në komunën e Studeniçanit marrin pjesë:

Sekretari: Burhanedin Nuhiju u lind më 17.01.1988 në Maranë të Komunës së Studeniçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje ndërsa arsimin e mesëm në Shkollën Ekonomike Juridike të qytetit të Shkupit “Arseni Jovkov”. Studimet deri-diplomike i mbaroi në Fakultetin Juridik Iustinianus Primus në Universitetin Shën Qirili dhe Metodi, ndërsa studimet post-diplomike i mbaroi në Univerzitetin FON, gjithashtu në fakultetin juridik në drejtimin e së drejtës civile. Objekt studimi i disertacionit të tij ishte “Vetëqeverisja lokale dhe informacionet me karakter publik”. Përveç gjuhës shqipe dhe gjuhës maqedonase ai zotëron edhe gjuhën angleze dhe atë turke. Burhanedin Nuhiju ka ndjekur disa trajnime si brenda poashtu edhe jashtë vendit. Në të njëjtën kohë ai është aktiv edhe në sektorin civil tash e ca vite. Nga viti 2009 deri në vitin 2013 ka punuar si mësimdhënës në SHF. Naim Frashëri- Studeniçan ndërsa nga viti 2013 e këndej punon në Komunën e Studeniçanit. Kurse në janar të vitit 2018 iu besua posti i sekretarit të Komunës së Studeniçanit.

⁶⁹ Statuti i komunës së Studeniçanit Nenet 20/21/22/23/24/25/26/27/28/29/30/31/32/33/34/35/36/37/38/39/40/41/42 (29-11-2020).

⁷⁰ Për më tepër shih në ueb faqen zyrtare të Komunës së Studeniçanit: <http://studenicani.gov.mk/> (Qasur më 01.12.2020).


Ejup Abazi: Udhëheqës i njësisë për menaxhim me resurset njerëzore.

Nuri Sadiki: Udhëheqës i njësisë për çështje financiare.

Iljaz Muhaxheri: Udhëheqës i njësisë për urbanizëm, veprimtari komunale dhe ambient.

Orhan Shabani: Udhëheqës i njësisë për zhvillim ekonomik lokal⁷¹.

Grafiku 2: Administrata komunale e Komunës së Studeniçanit:



⁷¹ Për më tepër shih në ueb faqen zyrtare të Komunës së Studeniçanit: <http://studenicani.gov.mk/> (Qasur më 01.12.2020).

Aktivitetet komunale

Rikonstruimi i rrugës Kitkë

Ka përfunduar edhe asfaltimi i rrugës për në Kitkë, pjesa prej në fsh. Koliçan të epërm deri te varrezat e fsh. Uji i kuq, me këtë u përfundua rikonstruksioni i kësaj pjese. Është kryer rikonstruksioni i rrugës me gjatësi prej 3km. Vlera e projektit është 17,676,400.00 denarë me tvsh ndërsa mjetet janë siguruar nga Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural dhe Komuna e Studeniçanit. Komuna e Studeniçanit përfundoi edhe një projekt shumë të rëndësishëm për banorët e Komunës së Studeniçanit dhe gjithë vizitorëve, duke e patur parasysh se në këtë pjesë gjindet mali Kitkë si atraksion turistik për gjithë Shkupin.

TIKA

Në shpërndarje që filloi nga fshati i Koliçanit të Poshtëm të Komunës Studeniçan në kryeqytetin Shkup, morën pjesë Ambasadori i Turqisë në Shkup, Hasan Mehmet Sekizkök, Koordinatori i TIKA-s në Shkup, Aytekin Ayden, Kryetari i Shoqatës ADEKSAM, Tahsin Ibrahim dhe banorët e fshatit. Ndihamat pas Koliçanit vazhduan të shpërndahen në fshatin Pagarushë. U shpërndanë gjithësej 100 pako, prej tyre 80 pako në fshatin Koliçan të Poshtëm dhe 20 pako në fshatin Pagarushë. Në emër të Komunës së Studeniçanit, mysafirët I mirëpriti drejtori i SH.F.K. "Mustafa Kemal Atatürk" z. Sabri Imer. Aktiviteti në fjalë u realizua në bashkpunim me OJQ YENI YILDIZ TURK DERNEGI nga fshati Koliçan i Poshtëm.



Dhurata e Autoambulancës

Duke e parë situatën e vështirë e cila ka kapluar vendin tonë si pasojë e përhapjes së virusit korona, me propozim të kryetarit të Komunës së Studeniçanit z. Azem Sadiku, Këshilli i Komunës së Studeniçanit në mbledhjen e jashtëzakonshme e mbajtur më 19/03/2020, solli Vendim që auto ambulanca pronë e Komunës së Studeniçanit ti dhurohet Ministrisë së shëndetësisë së RMV-së. Auto ambulanca në fjalë është e përgaditur me të gjitha paisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve mjekësore, dhe e njëjta do ti jepet në shërbim Shtëpisë së shëndetit publik-Shkup. Me këtë akt, Kryetari i Komunës së Studeniçanit z. Azem Sadiku shpreson që sado pak të lehtësohet puna e punonjësve mjekësorë në këtë situat mjaft të vështirë, por në të njëjtën kohë do të mundësojë edhe shërbime më të shpejta mjekësore pasi

auto ambulanca do të përdoret për të gjithë pacientët në nevojë. Për ndryshe Komuna e Studeniçanit ambulancën në fjalë e ka fituar si donacion nga Komuna Alltinova / Turqi.

Masat AntiCovid19

Komuna e Studeniçanit, me qëllim të marrjes së masave adekuate për parandalimin e infektimit me COVID -19 i njohur si “Koronavirusi” porositi të gjithë qytetarët që janë palë në Komunën e Studeniçanit, ta vizitojnë objektin administrativ të Komunës së Studeniçanit vetëm për lëndë që nuk kanë mundësi të prolongohen. Të gjitha lëndët tjera do të punohen pas marrjes së udhëzimeve nga Qeveria dhe Ministria e shëndetësisë së RMV-së.⁷² Në vijim është njoftimi i Komunës:

 <p>Република Северна Македонија / Republika e Maqedonisë së Veriut Општина Студеничани / Komuna e Studeniçanit</p>	<p>Ep./Nr. <u>03-297</u> Dat./dat. <u>13.03.2020</u> Општина Студеничани Komuna e Studeniçanit Ул./Rr.1 66/p.n. 1000 Сопње/Шкуп Tel:(02) 2724 005 Email: studenicani@studenicani.gov.mk Web: studenicani.gov.mk</p>
<p>ПРЕДМЕТ /LËNDA: ИЗВЕСТУВАЊЕ / LAJMËRIM.</p> <p>Почитувани, Тë nderuar</p>	
<p>Општина Студеничани, со цел преземање на соодветни мерки за спречување на инфекцијата со КОВИД-19, познат како “корона вирус”, препорачува до сите граѓани кои се странки во општина Студеничани, да ја посетат административната зграда на општина Студеничани само заради предмети кои не трпат одложување.</p>	<p>Комуна е Studeniçanit, me qëllim të marrjes së masave adekuate për parandalimin e infektimit me COVID -19 i njohur si “korona virus” porositi të gjithë qytetarët që janë palë në Komunën e Studeniçanit, ta vizitojnë objektin administrativ të Komunës së Studeniçanit vetëm për lëndë që nuk kanë mundësi të prolongohen.</p>
<p>Сите други предмети ќе се работат по добивање на препорака од страна на Владата и Министерството за здравство на РСМ.</p>	<p>Тë gjitha lëndët tjera do të punohen pas marrjes së udhëzimeve nga Qeveria dhe Ministria e shëndetësisë së RMV-së.</p>
<p>Студеничани, 13/03/2020 година</p>	<p>Studenica, 13/03/2020</p>
<p>Со почит,</p>	<p>Me respekt,</p>
<p>Општина Студеничани/ Komuna e Studeniçanit Градоначалник / Kryetar Azren Sadika /</p>	
<p>Ви благодариме на соработката / Ju falënderojmë për bashkëpunim</p>	

⁷² Për më tepër shih në ueb faqen zyrtare të Komunës së Studeniçanit: <http://studenicani.gov.mk/> (Qasur më 03.12.2020).

3.2.4 Ndërmarrjet dhe institucionet publike në Komunën e Studeniçanit

Drejtori I NPK: Erduan Saliju ka lindur me datë 29.12.1987 në fshatin Maranë. Shkollën fillore e ka kryer në Sh.F. “Naim Frashëri” Maranë ndërsa atë të mesmen në Shkollën e mesme “Cvetan Dimov” (2002-2006). Studimet deri diplomike i kreu në Fakultetin Ekonomik pranë Univerzitetit shtetëror të Tetovës, drejtimi: administratë biznesi (2009-2014). Nga viti 2014 e këndej punon në Komunën e Studeniçanit. Nga shkurti i vitit 2018 me Aktvendim të kryetarit të Komunës së Studeniçanit është emëruar për u.d. drejtor i NPK Studeniçani – Komuna e Studeniçanit⁷³.

Institucionet publike

SH.F.K. “NAIM FRASHERI”

